



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 754 / Prot.  
3

Koplik, më 07. 04. 2026

**V E N D I M**

**Nr. 12 Datë 02 / 04 / 2026**

*Mbi Planin Strehimit Bashkia Malesi e Madhe*

Bazuar ne ligjin Nr.139 date 17.12.2015 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”. Ligjit nr.22/2018,“Per Strehimin Social ne Republikën e Shqiperise, Ligji Nr.121/20216 Per Sherbimet e kujdesit Shoqeror ne Republikën e Shqiperise.

**V E N D O S I :**

1. Te miratoje Planin e Strehimit 2026-2030, bashkangjitur dokumentacioni perkates.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për Veteqeverisjen Vendore“;

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 02.04.2026

Vota Pro 16

Vota Kunder 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 03.04.2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 754/2 Prot.

Koplik, me 27.03.2026

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_ Date \_\_\_ / \_\_\_ /2026

**Lënda:** Dërgim dokumentacioni


*Mbi Planin Strehimit Bashkia Malesi e Madhe*

Bazuar ne ligjin Nr.139 date 17.12.2015 “Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”. Ligjit nr.22/2018,“Per Strehimin Social ne Republiken e Shqiperise, Ligji Nr.121/20216 Per Sherbimet e kujdesit Shoqeror ne Republiken e Shqiperise.

**PROPOZOJ:**


1. Te miratoje Planin e Strehimit 2026-2030, bashkangjitur dokumentacioni perkates.





# PLANI SOCIAL I STREHIMIT BASHKIA MALESHE MADHE

2026-2030



# TABELA E PËRMBAJTJES

---

1. HYRJE .....	
1.1 Qëllimi i planit .....	2
1.2 Metodologjia e përdorur .....	3
1.3 Korniza ligjore dhe strategjike .....	5
2. VIZIONI I BASHKISË MALËSI E MADHE .....	
2.1 Karakteristikat e përgjithshme .....	6
2.2 Popullsia dhe zhvillimi demografik .....	8
2.3 Struktura sipas moshës dhe gjinisë .....	9
3. ANALIZA SOCIALE DHE GRUPET NË NEVOJË .....	
3.1 Personat me aftësi të kufizuara .....	10
3.2 Familjet përfituese të ndihmës ekonomike .....	12
3.3 Punëkërkesit e papunë .....	13
3.4 Fëmijët dhe shërbimet sociale .....	15
4. ANALIZA E STREHIMIT NË TERRITOR .....	
4.1 Analiza e tregut të banesave .....	17
4.2 Analiza e ofertës për strehim .....	19
4.3 Analiza e nevojave për strehim .....	21
4.4 Analiza e grupeve vulnerabël .....	23
5. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT .....	
5.1 Vizioni i Bashkisë për strehimin .....	25
5.2 Objektivat strategjike .....	26
5.3 Objektivat e veçanta .....	27
6. PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL .....	
6.1 Qira sociale / Bonus strehimi .....	28
6.2 Banesa me kosto të ulët .....	29
6.3 Banesa të përkohshme .....	30
6.4 Banesa të specializuara .....	31
6.5 Përmirësimi i banesave ekzistuese .....	32
6.6 Zhvillimi i zonave për strehim .....	33
7. PLANI I ZBATIMIT .....	
7.1 Programet prioritare .....	34
7.2 Mekanizmat e zbatimit .....	35
7.3 Burimet financiare .....	36



8. PLANI I VEPRIMIT 2026–2030 .....	
8.1 Projektet prioritare .....	37
8.2 Përfituesit dhe ndikimi .....	38
8.3 Statusi dhe kapacitetet .....	39
9. MONITORIMI DHE VLERËSIMI .....	
9.1 Mekanizmat e monitorimit .....	40
9.2 Indikatorët e performancës .....	41
9.3 Raportimi dhe transparencia .....	42



## HYRJE

Ky plan vendor për strehimin social është hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe me Udhëzuesin për hartimin e planeve vendore të strehimit, të miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Struktura, objektivat dhe programet e planit pasqyrojnë plotësisht kornizën metodologjike dhe parimet e përcaktuara në këtë udhëzim, duke siguruar koherencë me politikat kombëtare dhe një qasje të standardizuar në nivel vendor.

Një ndër detyrat kryesore të Bashkisë Malësi e Madhe në fushën e strehimit është hartimi i programit 5-vjeçar të strehimit social 2026–2030, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”. Ky program përbën një kusht themelor për përfitimin e fondeve nga qeveria qendrore dhe instrumentet e tjera financiare, duke i dhënë mundësi Bashkisë Malësi e Madhe të identifikojë nevojat reale të banorëve për strehim dhe të planifikojë burimet buxhetore, teknike dhe institucionale për përmbushjen e tyre.

Në të njëjtën kohë, ky dokument shërben si një mjet i rëndësishëm referimi për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila, mbi bazën e të dhënave vendore dhe ecurisë së programeve në nivel bashkiak, vlerëson dhe rishikon periodikisht Strategjinë Kombëtare të Strehimit Social. Për Bashkinë Malësi e Madhe, ky plan është instrumenti kryesor për të garantuar që çdo familje të ketë akses në një strehim të përshtatshëm, të sigurt dhe të përballueshëm.

Programi vendor i strehimit social adreson një gamë të gjerë çështjesh, që lidhen me menaxhimin e burimeve financiare dhe të tokës, evidentimin e nevojave sipas të ardhurave dhe gjendjes sociale të familjeve, si dhe përcaktimin e masave për rritjen e fondit publik të banesave. Ai përfshin banesat sociale me qira dhe banesat me kosto të ulët, subvencionimin e qirave dhe kredive të buta, identifikimin e truallit të përshtatshëm për zhvillim, ndërtimin e banesave të reja, rikonstruksionin dhe përshtatjen e fondit ekzistues, si dhe krijimin e strehëve të përkohshme dhe banesave të specializuara për kategori të veçanta.

Ky plan vendos në qendër të vëmendjes **grupet vulnerabël dhe familjet me të ardhura të kufizuara**, të cilat përballen me vështirësi të mëdha për të hyrë në tregun e lirë të banesave. Përmes tij, Bashkia Malësi e Madhe synon të krijojë një sistem strehimi gjithëpërfshirës, që jo vetëm zgjidh nevoja emergjente, por kontribuon edhe në zhvillimin social dhe ekonomik të territorit. Përfshirja e komunitetit në procesin e hartimit dhe zbatimit, si dhe bashkëpunimi me partnerët qendrorë dhe ndërkombëtarë, e bëjnë këtë plan një dokument të gjallë, të bazuar mbi parime të transparencës, barazisë dhe qëndrueshmërisë.

Në këtë kuptim, Programi 5-vjeçar i Strehimit Social për Bashkinë Malësi e Madhe 2026–2030 nuk është vetëm një dokument i detyrueshëm ligjërish, por edhe një kornizë strategjike afatmesme që përkufizon vizionin dhe objektivat e bashkisë për sektorin e strehimit. Përmes tij, Malësi e Madhe synon të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve, të rrisë aksesin në strehim të përballueshëm për të gjitha grupet shoqërore, të forcojë kohezionin social dhe të garantojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në territorin e saj.



## 1.1 Qëllimi i planit

Qëllimi i hartimit të programit 5-vjeçar të strehimit social për Bashkinë Malësi e Madhe 2026–2030 është të njohë dhe identifikojë grupet vulnerabël dhe nevojat e tyre për strehim, si dhe të propozojë alternativa afatmesme për sigurimin e strehimit të përballueshëm, në përputhje me programet dhe dispozitat e legjislacionit përkatës. Në bazë të nenit 68 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare të strehimit social për popullsinë nën juridiksionin e tyre, të cilat miratohen nga Këshilli Bashkiak i Malësi e Madhe.

*Ky plan synon:*

- **Të vlerësojë kontekstin dhe nevojat për strehim social** për grupet e përcaktuara nga ligji, me fokus të veçantë tek familjet dhe individët më të cenuar në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe.
- **Të analizojë kapacitetet njerëzore, teknike, financiare dhe organizative** të bashkisë për të adresuar nevojat e identifikuar.
- **Të propozojë ndërhyrje konkrete**, të shoqëruara me vlerësime të qarta buxhetore dhe instrumente ligjore e financiare që mundësojnë zbatimin e tyre.
- **Të forcojë kohezionin social** dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm përmes politikave të strehimit të përballueshëm.

## 1.2 Metodologjia e përdorur

Metodologjia e hartimit të Planit Lokal të Strehimit për Bashkinë Malësi e Madhe është ndërtuar mbi një qasje të kombinuar, duke u fokusuar si në procesin e punës, ashtu edhe në përmbajtjen përfundimtare të planit. Fillimisht u realizua mbledhja, organizimi dhe sintetizimi i informacionit ekzistues, përmes të dhënave zyrtare nga CENS 2023, Regjistrit të Gjendjes Civile dhe statistikave të sektorit të shërbimeve sociale. Kjo qasje siguroi një panoramë të qartë mbi gjendjen e stokut të banesave, karakteristikat demografike dhe nevojat për strehim në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe.

Në vijim, u ndërmorën analiza të detajuara të situatës, të mbështetura në parashikimet e nenit 68 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe në udhëzuesin përkatës të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Analizat u përqendruan në:

- identifikimin e grupeve vulnerabël që kanë nevojë për mbështetje në strehim;
- vlerësimin e nevojave për strehim social dhe të përballueshëm;
- evidentimin e rreziqeve që lidhen me sigurinë e banesave dhe furnizimin me strehim;
- përcaktimin e burimeve të financimit (shtetëror, vendor dhe alternativ);
- analizimin e lidhjeve të programit me nisma të tjera zhvillimore në nivel vendor;
- përgatitjen e një profili të plotë social-ekonomik të bashkisë.



*Proçesi i hartimit u zhvillua sipas fazave të mëposhtme:*

Faza	Përshkrimi	Qëllimi
Faza I – Mbledhja e të Dhënave	Përdorimi i të dhënave zyrtare nga CENS 2023, Regjistri i Gjendjes Civile dhe statistikat bashkiake.	Sigurimi i bazës së besueshme të informacionit mbi gjendjen e banesave dhe nevojat për strehim.
Faza II – Vlerësimi dhe Prioritarizimi	Analiza e situatës aktuale dhe identifikimi i grupeve prioritare për strehim social.	Përcaktimi i nevojave më urgjente dhe vendosja e rendit të ndërhyrjeve.
Faza III – Hartimi i Planit të Veprimit	Formulimi i vizionit, objektivave strategjike e të veçantë, masave dhe programeve të strehimit.	Ndërtimi i një kornize të qartë dhe të zbatueshme për periudhën 2026–2030.
Faza IV – Draftimi i Planit	Hartimi i draftit dhe shqyrtimi i tij nga strukturat bashkiake dhe grupet e interesit.	Sigurimi i transparencës dhe përshtatja sipas rekomandimeve.
Faza V – Implementimi dhe Monitorimi	Zbatimi i programeve dhe monitorimi i rregullt i progresit.	Matja e rezultateve, rritja e efikasitetit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i planit

Proçesi përfshiu gjithashtu një fazë të gjerë konsultimesh me palët e interesuara dhe grupet e interesit. Këto u zhvilluan mbi draft-dokumentin e përgatitur, ku morën pjesë drejtoritë përgjegjëse dhe stafi brenda bashkisë, njësitë administrative, OJF-të partnere, si dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak. Konsultimi publik u zhvillua më , ku morën pjesë pjesëmarrës. Drafti i planit u publikua në faqen zyrtare të Bashkisë Malësi për të marrë sa më shumë sugjerime nga komuniteti.

Pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve, u finalizua versioni përfundimtar i planit dhe u realizua kostimi i veprimeve të dakordësuara. Ky version u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak, i cili e miratoi me vendim nr. \_\_, datë \_\_. Pas miratimit, plani do të publikohet në faqen zyrtare të bashkisë për transparencë të plotë.

### 1.3 Korniza ligjore dhe strategjike

Politikat lokale të Bashkisë Malësi e Madhe në fushën e strehimit social dhe të kujdesit shoqëror burojnë nga kuadri ligjor dhe dokumentet strategjike kombëtare, të cilat përcaktojnë standardet dhe detyrimet për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto dokumente sigurojnë harmonizimin e planeve vendore me prioritetet kombëtare dhe ofrojnë një kornizë të qartë për planifikimin, buxhetimin dhe zbatimin e programeve sociale.

Në nivel kombëtar, bazat kryesore janë:

- **Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”**, i cili përcakton përmbajtjen e programeve 5-vjeçare të strehimit dhe detyrimin e bashkive për t’i hartuar ato si instrumente zbatimi në nivel lokal.
- **Strategjia Kombëtare e Strehimit Social 2016–2025**, e cila ka shërbyer si dokumenti orientues kryesor për zhvillimin e politikave të strehimit dhe aktualisht është në proçes rishikimi për të reflektuar nevojat e reja të komuniteteve dhe synimet e zhvillimit të qëndrueshëm.



- **Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2019–2022**, e cila ka synuar ndërtimin e një sistemi të integruar dhe funksional të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve.
- **Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”**, së bashku me aktet nënligjore përkatëse, ku përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë e bashkive për ngritjen, financimin dhe administrimin e shërbimeve sociale.
- **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**, i cili në nenin 24 përcakton funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale dhe të strehimit si pjesë e kompetencave të veta të përgjithshme.

Një rol të rëndësishëm udhëzues ka edhe **“Udhëzuesi për përgatitjen e Programit Lokal 5-Vjeçar për Strehimin Social”**, i cili shërben si manual praktik për bashkitë. Ky dokument orienton procesin nga analiza e situatës së banimit dhe konsultimet me komunitetin, deri te hartimi i objektivave, përcaktimi i programeve prioritare, buxheti dhe monitorimi. Udhëzuesi siguron që programet vendore të jenë të harmonizuara me strategjitë kombëtare dhe të reflektojnë realitetet lokale, por gjithashtu kontribuojnë edhe në përputhjen me praktikat dhe objektivat europiane për strehimin social dhe kohezionin shoqëror.

Në nivel lokal, një dokument themelor është **Plani Social Vendor i Bashkisë Malësi e Madhe 2025-2027**, i cili përkufizon vizionin dhe objektivat për zhvillimin e shërbimeve sociale, përfshirë edhe masat për strehimin e grupeve në nevojë. Ky plan identifikon prioritetet sociale të komunitetit, burimet që duhen mobilizuar dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke krijuar një bazë të fortë për ndërthurjen e politikave sociale me ato të strehimit. Integrimi i këtij plani me Programin 5-vjeçar të Strehimit Social siguron koherencë, gjithëpërfshirje dhe një qasje të balancuar për mbështetjen e shtresave më vulnerabël të popullsisë.



## Vizioni i Bashkisë Malesi e Madhe

Vizioni i Bashkisë Malesi e Madhe për sektorin e strehimit është garantimi i kushteve të banimit të përshtatshme, të sigurta dhe të përballueshme për të gjithë qytetarët, me fokus të veçantë tek familjet dhe individët më vulnerabël. Bashkia synon të krijojë një territor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, ku strehimi social të mos shihet vetëm si një instrument ndihme afatshkurtër, por si pjesë integrale e zhvillimit social, ekonomik, urban dhe mjedisor të Malësi e Madhe.

*Ky vizion mbështetet në parimet e mëposhtme:*

- **Përballueshmëri** – sigurimi i banesave me kosto të arsyeshme për familjet me të ardhura të ulëta.
- **Akses dhe barazi** – garantimi i strehimit social për të gjitha grupet vulnerabël, pa diskriminim dhe me mundësi të barabarta.
- **Integrim me shërbimet** – lidhja e strehimit me aksesin në transport, shëndetësi, arsim dhe tregun e punës.
- **Qëndrueshmëri dhe dimension i gjelbër** – përdorimi i tokës dhe burimeve financiare në mënyrë efektive, me respekt ndaj mjedisit dhe planifikimit urban; promovimi i banesave me efikasitet energjetik, hapësirave të gjelbra dhe zgjidhjeve të qëndrueshme për ujin e mbetjet.
- **Partneritet dhe bashkëpunim** – nxitja e bashkëpunimit mes qeverisjes vendore, qeverisë qendrore, sektorit privat dhe partnerëve ndërkombëtarë për rritjen e fondit të banesave sociale.

## Karakteristikat e Përgjithshme

- Njësitë administrative : Koplik, Gruemirë, Kastrat, Kelmend, Qendër, Shkrel

### 2. Popullsia

- Sipas Censurit 2023: 21.684 banorë
- Sipas Regjistrimit Civil 2025: 53,918 banorë

### 3. Zhvillimi i Popullsisë

Viti	Popullsia
2001	36,700
2011	30,823
2020	28,222
2023	21,684



#### 4. Strukturë gjinore dhe mosha (2023)

- Meshkuj: 10,879
- Femra: 10,805
- 0-14 vjeç: 2,957
- 15-64 vjeç: 13,793
- 65+ vjeç: 4,934

Të dhëna mbi individët/grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror

Personat me aftësi të kufizuara

Sipas të dhënave të Bashkisë Malësi e Madhe dhe të paraqitura në tabelën në vijim, rezultojnë 793 persona me aftësi të kufizuara fizike e mendore, me probleme shikimi dhe me statusin e para-tetraplegjikut, nga të cilët 101 janë fëmijë (0-18 vjeç). Pra 12,7% e personave të vlerësuar nga Komisionet mjeksore si PAK janë fëmijë.

33% e personave me aftësi të kufizuara (259 persona) kanë diagnoza të rënda pasi mbështeten tek një person që përfiton pagesën e kujdestarit nga skema e mbrojtjes sociale.

Brenda aftësisë së kufizuar grupi më i madh është ai i personave me probleme të shëndetit mendor dhe fizik, 590 persona ose 74% e totalit kanë probleme të shëndetit mendor dhe fizik. Personat me statusin e para-tetraplegjikut janë 102, ndërsa 101 individë kanë probleme me shikimin.

Tabela 1: Personat me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative

EMËRTIMI	GJITHSEJ		VERBËR		PARA-TETRAPLEGJIK	PAK MENDOR FIZIK		
	Gjithsej	Me përfitim kujdestari	Gjithsej	Me përfitim kujdestari		Gjithsej	Me përfitim kujdestari	
BASHKIA	793	259	101	29	102	101	590	129
Koplik	140	47	33	12	18	18	89	17
Qendër	77	29	4	0	13	13	60	16
Kastrat	195	64	24	6	26	26	145	32
Shkrel	105	35	13	3	16	15	76	17
Gruemirë	163	48	13	6	18	18	132	24
Kelmend	113	36	14	2	11	11	88	23



### 3.2 Familje përfituese të ndihmës ekonomike

Sipas të dhënave të Bashkisë Malësi e Madhe 741 familje përfituan ndihmën ekonomike në këtë Bashki në vitin 2025.

Megjithatë niveli i përfshirjes në skemë (raporti mes numrit të aplikantëve dhe numrit të përfituesve) mbeten i lartë, pasi 87% e familjeve që kanë aplikuan për ndihmë e kanë përfituar atë.

### 3.3 Punëkërkes të papunë

Sipas të dhënave të Zyrës së Punës në Bashkinë Malësi e Madhe janë të regjistruar 1082 punëkërkes, nga të cilët 550 femra dhe 532 meshkuj. Pra, 50.8% e punëkërkesve në zyrat e punës janë femra. 64% e punëkërkesve në zyrat e punës i përket grupmoshës mbi 40 vjeç. Vetëm 5 persona me aftësi të kufizuara janë regjistruar si punëkërkes të papunë, sikurse 23 emigrantë të kthyer dhe 41 gra kryefamiljare rezultojnë punë kërkes në zyrat e punës.

Specifikisht:

Tabela 6: Punëkërkes të regjistruar në Zyrat e Punës sipas gjinisë dhe statusit

Grupmosha	SIPAS GJINISË		SIPAS STATUSIT					
	Femra	Meshkuj	Jetim	PA K	Romë/ Egjiptjane	Emigrate te kthyer	Gra kryefamiljare	gra te dhunuara/ rafikuara
16-19 vjec	15	35				3		
20-24 vjec	42	77				3		
25-29 vjec	40	52		1			2	
30-39 vjec	70	56		2		8	7	
40+	383	312		3		9	32	
Total	550	532		5		23	41	

Në këndvështrimin e nivelit arsimor të punëkërkesve të regjistruar në zyrat e punës rezulton se 62% e tyre kanë arsimin 9 vjeçar dhe 31% kanë arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Tabela 7: Punëkërkes të regjistruar në Zyrat e Punës sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor	Femra	Meshkuj	TOTALI	%
Pa arsim	1	0	1	0,09
Filllore	21	13	34	3,1



9 vjecare	365	305	670	61,9
-----------	-----	-----	-----	------

### Fëmijët

Grupi Ndërsektorial ad hoc nuk funksionon ende në Bashkinë Malësi e Madhe, por Grupi teknik ndërsektorial mblidhet vazhdimisht sipas kërkesave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Në sektorin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale ka njësi të mbrojtjes së fëmijës dhe në të gjitha njësitë administrative. Punonjësi social i këtij sektori menaxhon në bashkëpunim edhe administratorët shoqëror rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe shërbime.

Tabela 8: Treguesit për fëmijët

Nr.	TREGUESIT	2025
1	Numri total i fëmijëve të lënë pa kujdes prindëror (gjatë vitit)	2
2	Numri total i fëmijëve në kujdes rezidencial (në fund të vitit)	2
3	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kujdes rezidencial (në fund të vitit)	0
4	Numri dhe % e fëmijëve deri në 18 vjeç të identifikuar me probleme nga përdorimi i drogës;	0
5	Numri i fëmijëve deri në 18 vjeç që trajtohen për problemet e alkoolit;	0
6	Numri i rasteve të fëmijëve të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Arrestuar;</li> <li>- ndaluar;</li> <li>- Dënuar;</li> </ul>	0
7	Numri i fëmijëve në familjet përfituese të ndihmës ekonomike, për secilën njësi administrative	2,632 fëmijë <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Koplik 405</li> <li>✓ Qendër 452</li> <li>✓ Kastrat 498</li> <li>✓ Shkrel 378</li> <li>✓ Gruemirë 507</li> <li>✓ Kelmend 392</li> </ul>
8	Numri i fëmijëve të vendosur në familje kujdestare	3
9	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara	101 fëmijë <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Koplik 13</li> </ul>




		✓ Qendër 23 ✓ Kastrat 20 ✓ Shkrel 20 ✓ Gruemirë 15 ✓ Kelmend 10
--	--	---

## Analiza e strukturës së popullsisë dhe masat e strehimit social

*Analiza tregon se nevojat për strehim social ndryshojnë sipas grupmohave:*

- Për fëmijët dhe të rinjtë deri në 14 vjeç është e domosdoshme sigurimi i kushteve të përshtatshme të jetesës dhe afërsia me shërbimet arsimore (çerdhe, kopshte, shkolla).
- Për të rinjtë aktivë 15–34 vjeç kërkohen banesa të përballueshme që mbështesin pavarësinë ekonomike dhe krijimin e familjes së re.
- Për grupmohën 35–64 vjeç, që përbën forcën kryesore të punës dhe stabilitetin ekonomik të komunitetit, fokusi duhet të jetë tek përmirësimi i kushteve ekzistuese të banimit dhe sigurimi i hapësirave funksionale.
- Për të moshuarit 65+ vjeç nevojiten banesa të përshtatura dhe shërbime të specializuara, në përputhje me tendencën e plakjes demografike.

*Nevojat për strehim sipas grupmohave në Bashkinë Malësi e Madhe*



Grafiku paraqet nevojat për strehim social të diferencuara sipas grupmohave në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe. Për fëmijët dhe të rinjtë deri në 14 vjeç theksi vihet tek sigurimi i kushteve të përshtatshme të jetesës dhe afërsia me institucionet arsimore. Për të rinjtë 15–34 vjeç,

kërkesa kryesore lidhet me banesa të përballueshme që mundësojnë pavarësi ekonomike dhe krijimin e familjeve të reja. Grupi 35–64 vjeç, si forca kryesore e punës dhe stabiliteti ekonomik i komunitetit, ka nevojë për përmirësimin e kushteve ekzistuese të banimit dhe për hapësira funksionale. Ndërsa për të moshuarit mbi 65 vjeç kërkohen banesa të përshtatura dhe shërbime të specializuara, në përputhje me procesin e plakjes demografike.

### Analiza e grupeve vulnerabël dhe nevojave për strehim

Grupi vulnerabël	Karakteristikat kryesore	Nevojat për strehim	Programet e përshtatshme	Kërkesa / Gjendja aktuale (2025)	Oferta / Burimet e financimit
Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK)	PAK fizikë/mendorë; kërkojnë përshtatje banese dhe akses pranë shërbimeve	Banesa të përshtatura, afër qendrave shëndetësore dhe sociale	Banesa të specializuara; qira sociale; programe rikonstruksioni	Rastet evidentohen dhe trajtohen nga Bashkia	Bashkia (qira sociale); Qeveria qendrore (banesa të specializuara); Donatorë (përshtatje banesash)
Gratë viktime të dhunës	Shpesh me fëmijë; në rrezik social	Strehim emergjent dhe afatmesëm, të sigurt	Banesa të përkohshme; banesa të specializuara; qira sociale	Rastet evidentohen dhe trajtohen nga Bashkia	Bashkia (qira sociale); Qeveria qendrore (strehim emergjent); Donatorë (mbështetje psikosociale + banesa të dedikuara)
Gratë e divorcuara me fëmijë	Të ardhura të kufizuara; përgjegjësi për kujdesin e fëmijëve	Banesa me qira të subvencionuar; banesa afatgjata	Programi i Qirasë Sociale; strehim i përkohshëm në raste urgjente	Kërkesat evidentohen dhe mbulohen pjesërisht nga Bashkia	Bashkia (qira sociale); Donatorë (mbështetje sociale)
Të moshuarit e vetmuar	Jetojnë vetëm; shpesh me pension minimal	Banesa të përshtatura dhe të sigurt	Banesa të specializuara; qira sociale	Rastet evidentohen dhe trajtohen nga Bashkia	Bashkia (qira sociale); Qeveria qendrore (banesa të specializuara)
Të rinjtë (15–34 vjeç)	Kërkojnë kushte për pavarësi dhe krijim familjeje	Banesa me kosto të ulët; kredi të buta	Programi i BKU; kredia e butë;	Aplikime për kredi të buta; shqyrtohen nga ana e komisionit për shyrtrimin e aplikimeve	Qeveria qendrore (subvencione kredie); Enti Kombëtar i Banesave; Bashkia (mbështetje në aplikim)
Familjet me shumë fëmijë	Shpenzime të larta; nevojë për hapësirë më të madhe	Banesa më të mëdha; rikonstruksion	Qira sociale; rikonstruksion banesash ekzistuese	Rastet evidentohen dhe trajtohen nga Bashkia	Bashkia (qira sociale); Donatorë (mbështetje për rikonstruksion)



Grupet vulnerabël që kanë nevojë për strehim në Bashkinë Malësi e Madhe përfshijnë kategori të ndryshme të shoqërisë, të cilat kërkojnë mbështetje të posaçme për të siguruar kushte të denja jetese, siç vijon:

- **Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK)**

Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një ndër grupet më të ndjeshme të shoqërisë, të cilët shpesh përballen me barriera të shumta – ekonomike, shoqërore dhe fizike – për të siguruar një banesë të përshtatshme. (të cilat e bëjnë të vështirë sigurimin e një banese të përshtatshme)

Për këtë kategori nuk është e mjaftueshme vetëm ofrimi i një strehe, por është e domosdoshme që banesa të plotësojë standardet e aksesueshmërisë dhe përshtatjes funksionale, në mënyrë që individët të kenë një jetë të pavarur dhe dinjitoze.

- **Gratë e divorcuara**

Gratë e divorcuara, veçanërisht ato që janë kujdestare të fëmijëve, përbëjnë një kategori me risk të lartë për sa i përket mbetjes pa strehë. Shpesh pa mbështetje ekonomike dhe me të ardhura të pamjaftueshme, ato hasin vështirësi të mëdha për të përballuar koston e qirasë ose blerjen e një banese në tregun e lirë. Mbështetja e tyre përmes programeve të banesave sociale me qira dhe subvencionimit të qirasë është thelbësore për t'u siguruar stabilitet dhe siguri për veten dhe fëmijët e tyre.

- **Viktimat e dhunës në familje**

Viktimat e dhunës, kryesisht gratë dhe fëmijët e tyre, kanë nevojë emergjente për strehim të sigurt dhe mbrojtje. Ato shpesh detyrohen të braktisin bancesën ku kanë jetuar, duke u gjendur pa mundësi alternative. Për këtë kategori, Bashkia Malësi e Madhe duhet të parashikojë si strehim emergjent të përkohshëm, ashtu edhe zgjidhje afatgjata në formën e banesave sociale ose të specializuara, duke krijuar kushte që u mundësojnë një jetë të pavarur dhe të sigurt.

Në këtë kuadër, politikat e strehimit social të Bashkisë Malësi e Madhe duhet të fokusohen në ofrimin e mbështetjes së diferencuar për secilin grup vulnerabël, duke garantuar që programet e parashikuara në planin 5-vjeçar të përgjigjen realisht ndaj nevojave të tyre specifike dhe të sigurojnë kushte të denja jetese për çdo qytetar.

Në Bashkinë Malësi e Madhe, grupet vulnerabël që kanë nevojë për mbështetje në strehim përfshijnë kategori të ndryshme të popullsisë, të cilat preken nga faktorë ekonomikë, socialë dhe demografikë.

**Personat me aftësi të kufizuara** përballen me barriera të shumta për të siguruar një banesë të përshtatshme dhe të aksesueshme, duke kërkuar programe të posaçme për përshtatjen e banesave.



**Gratë e divorcuara**, sidomos kur janë kujdestare të fëmijëve, janë të ekspozuara ndaj rrezikut të mungesës së strehimit për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme, ndaj mbështetja përmes qirave sociale dhe subvencioneve është thelbësore.

**Viktimat e dhunës në familje** kërkojnë zgjidhje emergjente dhe afatgjata për të jetuar në siguri, ndërsa të **moshuarit e vetmuar** kanë nevojë për banesa të përshtatura dhe shërbime afër komunitetit për të shmangur izolimin.

Një tjetër kategori janë **familjet me të ardhura të ulëta**, që përballen me vështirësi për të përballuar tregun e lirë të banesave dhe për këtë arsye kërkojnë mbështetje për qira ose banesa sociale.

**Të rinjtë**, në tranzicion drejt punësimit dhe formimit të familjes, kanë nevojë për programe strehimi që i ndihmojnë të qëndrojnë në komunitet dhe të shmangin migrimin.

Gjithashtu, **familjet me shumë fëmijë** janë më të rrezikuara për shkak të shpenzimeve të larta dhe kërkojnë forma strehimi që i përgjigjen numrit të madh të anëtarëve.

Kjo analizë tregon se nevojat për strehim në Malësi e Madhe janë të larmishme dhe kërkojnë një qasje të kombinuar mes **banesave sociale me qira, subvencionimit të qirave, programeve të përshtatjes së banesave dhe programeve të specializuara për grupet më të ndjeshme**, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe udhëzuesin për programet vendore të strehimit social.

Në këtë kuadër, Bashkia Malësi e Madhe do të ndërthurë instrumente të ndryshme të strehimit social – nga subvencionimi i qirave te ndërtimi i banesave sociale dhe programet e specializuara – duke u dhënë përparësi grupeve më të prekshme dhe duke siguruar që askush të mos mbetet pa strehë

## Analiza e tregut të banesave në Bashkinë Malësi e Madhe

Sipas të dhënave të **Censusit 2023**, Bashkia Malësi e Madhe numëron gjithsej **8633 banesa të zakonshme**, nga të cilat **6,293 janë të banuara** dhe **2,340 të pabanuara**. Kjo tregon se rreth **37.1% e fondit të banesave** është i papërdorur, duke përbërë një potencial të rëndësishëm për politika të ripërdorimit dhe përfshirjes në programe të strehimit social.

- Struktura e banesave sipas tipologjisë paraqitet si më poshtë:

**Shtëpi individuale** – 6510njësi që tregojnë karakterin rural të territorit dhe mbështetjen tek banesa e ndërtuar vetë.

**Apartamente** – 261 njësi të përqendruara kryesisht në qytetin e Koplikut dhe Bajzes

Të dhënat e CENS 2023 japin një pasqyrë të qartë mbi strukturën dhe përdorimin e banesave në Bashkinë Malësi e Madhe, duke ndihmuar në orientimin e politikave të strehimit social dhe të përballueshëm, sipas CENS 2023, në Bashkinë Malësi e Madhe ka gjithsej **8.633 banesa**, ku



**6.293janë të banuara dhe 2.340 të pabanuara.** Ky potencial i banesave të zbratura mund të shfrytëzohet për **strehimin social**, duke u ripërdorur ose rikonstruktuar për qira të subvencionuara. Kjo qasje do të ulte nevojën për ndërtim të ri dhe do të siguronte zgjidhje më të shpejta për grupet vulnerabël.

**Çmimi i qirave** mbetet një faktor vendimtar për familjet vulnerabël që nuk disponojnë banesa në pronësi, ndërkohë që tregu i qirave në këtë zone është i kufizuar dhe shpesh i paformalizuar. Aktualisht, qiraja mesatare për një apartament 1+1 vlerësohet rreth 120–160 €/muaj, ndërsa për një 2+1 rreth 160–200 €/muaj.

Nga ana tjetër, **çmimi i shitjes** së banesave në Malësi e Madhe mbetet relativisht i kufizuar, me orientim më të madh drejt shtëpive individuale dhe më pak drejt banesave kolektive. Në zonat urbane, çmimi mesatar i shitjes për një apartament është rreth 350–370 €/m<sup>2</sup>, ndërsa për shtëpitë individuale, duke marrë parasysh zonën dhe cilësinë e ndërtimit, mesatarisht është 350–380 €/m<sup>2</sup>.

Të dhënat e përdorura në këtë analizë mbështeten në informacionet e publikuara zyrtarisht nga **Ministria e Financave, 24 korrik 2025**, duke siguruar një pasqyrë të saktë dhe të azhurnuar të tregut të qirave dhe shitjeve të banesave në Malësi e Madhe.

Ky realitet i të dhënave e **CENS 2023** mbi strukturën dhe përdorimin e banesave, së bashku me treguesit e **situatës aktuale të qirave dhe shitjeve** – tregon se politikat e strehimit social në Bashkinë Malësi e Madhe duhet të fokusohen në dy drejtime kryesore:

1. **Ripërdorimi dhe rikonstrukcioni i banesave ekzistuese të pabanuara**, për të ofruar zgjidhje të menjëhershme e të përballeshme për familjet dhe grupet vulnerabël;
2. **Krijimi i banesave kolektive urbane**, për të diversifikuar fondin e banesave dhe për t’iu përgjigjur kërkesës së pritur në rritje në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Tregu i banesave në Bashkinë Malësi e Madhe paraqet sfida të dukshme, por njëkohësisht edhe mundësi reale për zhvillimin e programeve të strehimit social, të cilat duhet të ndërtohen mbi ripërdorimin e fondit ekzistues dhe orientimin drejt banesave kolektive të përballeshme.

*Tregu i qirave* mbetet një faktor vendimtar për familjet që nuk disponojnë banesa në pronësi. Aktualisht, qiraja mesatare në Malësi e Madhe është:

Tipologji Banimi	Qira Mesatare €/muaj
Apartament 1+1	120–160
Apartament 2+1	160–200

*Çmimi i shitjes* së banesave në Malësi e Madhe mbetet relativisht i kufizuar, me një orientim më të madh drejt shtëpive individuale:

Tipologji Banimi	Çmim Mesatar €/m <sup>2</sup>
Apartament urban	350–370
Shtëpi individuale	350–380



Bashkia Malësi e Madhe parashikon që vlerat maksimale të *subvencionimit të qirasë* për familjet në nevojë të jenë:

Tipologji Banimi	Subvencion Maksimal Lek/Muaj
Banesa 1+1	6500
Banesa 2+1	11000
Shtëpi Private 2+1	13500
Shtëpi Private 3+1	16500

Ky realitet tregon se politikat e strehimit social duhet të ndërtohen mbi ripërdorimin e fondit ekzistues dhe orientimin drejt banesave kolektive të përballueshme. Integrimi i informacionit mbi tregun e banesave me nevojat e grupeve vulnerabël ndihmon Bashkinë Malësi e Madhe të ofrojë zgjidhje të përballueshme dhe të aksesueshme për familjet dhe individët në nevojë, duke siguruar që askush të mos mbetet pa strehë

Analiza e ofertës për strehim në Bashkinë Malësi e Madhe ka për qëllim të evidentojë burimet reale që mund të vihen në dispozicion për përmbushjen e nevojave të identifikuara në kuadër të programeve të strehimit social. Kjo analizë bazohet mbi dy shtylla kryesore:

- ❖ **Banesat ekzistuese**, të cilat mund të përshtaten ose ripërdoren për strehim social;
- ❖ **Trojet dhe hapësirat potenciale**, që mund të shfrytëzohen për ndërtimin e banesave të reja sociale;

Ky proces analize ndihmon në përcaktimin e masave konkrete për përdorimin efikas të resurseve dhe për hartimin e një programi realist e të qëndrueshëm për periudhën 5-vjeçare. Krahas tregut privat të banesave, ndërhyrjet publike përmes **subvencionimit të qirasë** dhe **projekteve të banesave sociale** janë thelbësore për të mbuluar boshllëqet që ky treg lë për familjet me të ardhura të ulëta.

Në analizën e strehimit social janë përdorur si të dhënat e Censurit 2023, ashtu edhe ato të Regjistrimit të Gjendjes Civile. Diferencat mes dy burimeve tregojnë se një pjesë e familjeve janë të regjistruara në Bashkinë Malësi e Madhe, por aktualisht jetojnë jashtë territorit. Kjo situatë shpjegon hendekun mes numrit të familjeve dhe stokut të banesave të banuara.

Ndërkohë, fondi i banesave të pabanuara, edhe pse nuk përbën strehim publik, mbetet një burim potencial për të rritur ofertën e banesave sociale nëpërmjet programeve të qirasë së subvencionuar nga bashkia.

Një pjesë e konsiderueshme e banesave të pabanuara në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe i përket kryesisht familjeve emigrante, të cilat nuk i përdorin këto pasuri në mënyrë të rregullt. Ky fond banesash, edhe pse aktualisht nuk është i integruar në politikat vendore, përbën një potencial të madh për t'u shfrytëzuar në funksion të strehimit social. Bashkia Malësi e Madhe, përmes një skeme të **subvencionimit të qirasë sociale**, mund të ndërmjetësojë marrëveshje me pronarët e këtyre banesave, duke paguar qiranë sipas çmimeve të tregut të lirë për familjet dhe individët në nevojë. Një qasje e tillë do të kishte dy përfitime kryesore: nga njëra anë, pronarët do të siguronin të ardhura të rregullta nga



një pasuri e paluajtshme e pashfrytëzuar; nga ana tjetër, familjet vulnerabël do të përfitonin një strehim të sigurt, të përbalueshëm dhe dinjitoz. Ky model, megjithëse ende i paimplementuar në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe, mund të shërbejë si mekanizëm fleksibël dhe i menjëhershëm për të plotësuar boshllëqet aktuale të strehimit, **derisa niveli qendror, në bashkëpunim me Bashkinë dhe partnerët privatë apo ndërkombëtarë, të mundësojë ndërtimin e banesave të reja sociale dhe të qëndrueshme**

## 2.4 Analiza e nevojave për strehim

Në kuadër të hartimit të Programit 5-vjeçar të Strehimit Social, Bashkia Malësi e Madhe ka kryer analizën e nevojave për strehim, me fokus tek grupet vulnerabël që përballen me vështirësi të theksuara në sigurimin e një banese të përshtatshme. Kjo analizë bazohet në **Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”** dhe në **Udhëzuesin për planet vendore të strehimit**, të cilët përcaktojnë kategoritë prioritare që përfitojnë nga programet e strehimit social.

Nevojat për strehim social në Bashkinë Malësi e Madhe burojnë nga një kombinim faktorësh socialë, ekonomikë dhe demografikë, që prekin kryesisht grupet më vulnerabël të komunitetit. Këto kategori, të cilat trajtohen me prioritet nga ligji dhe udhëzuesi përkatës, janë identifikuar si përfituesit kryesorë të programeve të strehimit social.

Grupet që trajtohen me prioritet janë: **personat me aftësi të kufizuara (PAK, gratë kryefamiljare (veçanërisht të divorcuara ose pa mbështetje), viktimat e dhunës në familje**, si dhe kategori të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Grupi vulnerabël	Numri (familje/individ)	Karakteristikat kryesore	Nevojat për strehim	Programet e përshtatshme	Prioriteti (1-5)
Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK)	689 persona	PAK fizikë e mendorë; kërkojnë përshtatje dhe shërbime sociale	Banesa të përshtatura, afër shërbimeve	Banesa të specializuara; përshtatje banesash; subvencione qiraje	5
Komuniteti Rom	Nuk ka	0	0	0	0
Gratë e divorcuara	182 gra	Shumë me fëmijë në ngarkim; të ardhura të kufizuara	Banesa me qira të subvencionuar; strehim emergjent	Qira sociale; banesa të përkohshme	3
Viktimat e dhunës në familje	15 raste	Rastet kërkojnë mbrojtje emergjente dhe strehim të sigurt	Strehim emergjent dhe afatmesëm	Banesa të përkohshme; banesa të specializuara	5
Të moshuarit e	300 të moshuar	Jetojnë vetëm;	Banesa të	Banesa të	4



vetmuar		shpesh me probleme shëndetësore dhe të ardhura minimale	përshtatura; shërbime komunitare	specializuara; rikonstruksione	
Familjet me të ardhura të ulëta / NE	588 familje	Jetojnë me ndihmë ekonomike; kushte të dobëta banimi	Qira sociale; rikonstruksion banesash	Qira sociale; programe për përmirësim banesash	5
Të rinjtë (15–34 vjeç)	individë	Kërkojnë pavarësi, punësim, kushte për familje	Banesa me kosto të ulët	Banesa me kosto të ulët; kredi të subvencionuara	3
Familjet me shumë fëmijë	familje	Kërkojnë hapësirë më të madhe; shpenzime të larta	Banesa më të mëdha ose rikonstruksione	Përmirësim i kushteve ekzistuese; qira sociale	4

Për të siguruar një qasje të strukturuar, Bashkia Malësi e Madhe ka ndërtuar matricën e mëposhtme, e cila do të plotësohet me të dhënat konkrete gjatë procesit të zbatimit dhe monitorimit të planit.

### Analiza e ofertës

Analiza e ofertës për strehim në Bashkinë Malësi e Madhe ka për qëllim të evidentojë burimet reale që mund të vihen në dispozicion për përmbushjen e nevojave të identifikuar në kuadër të programeve të strehimit social. Ajo mbështetet në të dhënat e vitit 2025 dhe reflekton si situatën aktuale, ashtu edhe potencialet e zhvillimit për periudhën 2026–2030.

*Në praktikë, kjo analizë bazohet mbi katër shtylla kryesore:*

1. **Trojet dhe hapësirat publike**, të cilat mund të shfrytëzohen për ndërtimin e banesave të reja sociale në partneritet me Entin e Banesave dhe qeverinë qendrore, si pjesë e projekteve afatgjata.
2. **Proçesi i legalizimit**, i cili përfshin familje vulnerabël që banojnë në objekte informale dhe përmes përshtetimit të procedurave të AShK-së, mund të integrohen në programet sociale të strehimit, duke fituar siguri ligjore dhe stabilitet banesor.
3. **Banesat e specializuara**, të destinuara për grupe në rrezik si viktimat e dhunës në familje, PAK apo të moshuarit. Nga 15 raste të dhunës të adresuara në Bashki, një pjesë tashmë janë mbuluar përmes një prej formave ekzistuese të trajtimit, çka tregon nevojën për forcim të këtij programi në vitet në vijim.

Kjo qasje e integruar ndihmon në përcaktimin e masave konkrete për përdorimin efikas të resurseve dhe për hartimin e një programi realist e të qëndrueshëm për periudhën 2026–2030, duke balancuar ndërhyrjet emergjente me projektet afatgjata dhe duke siguruar mbrojtje sociale për grupet më vulnerabël.



Analiza e ofertës së strehimit në Bashkinë Malësi e Madhe evidenton burimet kryesore mbi të cilat mbështeten aktualisht programet sociale dhe perspektivat për zgjerimin e tyre në periudhën 2026–2030. Aktualisht, bashkia ka siguruar mbulim të drejtpërdrejtë 3 raste të dhunës në familje, të cilat janë trajtuar përmes një prej formave të strehimit të ofruara (strehim i përkohshëm, banesa të specializuara ose mbështetje me qira sociale). Këto të dhëna tregojnë se, edhe pse kapacitetet janë të kufizuara, mekanizmat ekzistues funksionojnë si zgjidhje emergjente dhe fleksibël.

Trojet publike të vëna në dispozicion nga Bashkia dhe Enti i Banesave përfaqësojnë një burim strategjik për zbatimin e projekteve të reja, megjithëse kërkojnë angazhim financiar shtesë dhe partneritete me qeverinë qendrore dhe donatorët. Në të njëjtën kohë, procesi i legalizimit i banesave informale mbetet një instrument i rëndësishëm për integrimin e familjeve vulnerabël në skemat e strehimit social, duke forcuar sigurinë juridike të banimit.

Nga ana tjetër, banesat e specializuara për kategori të caktuara – si gratë viktime të dhunës, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit e vetmuar apo familjet në rrezik social – janë një alternativë e domosdoshme që siguron strehim të përshtatshëm dhe mbështetje afatmesme. Këto ndërhyrje, të kombinuara me skemat e kredisë së butë dhe bonusin e strehimit, krijojnë një ofertë të balancuar që shkon përtej mbulimit emergjent dhe synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm strehimi social.

Në përfundim, kombinimi i burimeve ekzistuese (trojet publike, procesi i legalizimit dhe banesat e specializuara) me mbështetjen financiare të bashkisë, shtetit dhe partnerëve të jashtëm, krijon një kuadër të qartë për realizimin e objektivave të Planit 5-vjeçar të Strehimit Social 2026–2030. Kjo qasje integruese siguron një balancë ndërmjet nevojave emergjente dhe projekteve afatgjata, duke garantuar strehim më të sigurt, gjithëpërfshirës dhe dinjitoz për qytetarët në nevojë.

## Vizioni i Bashkisë Malësi e Madhe për strehimin 2026–2030

Vizioni i Bashkisë Malësi e Madhe për strehimin social mbështetet në krijimin e një komuniteti gjithëpërfshirës, ku çdo qytetar ka mundësi të barabarta për të jetuar në kushte të sigurta, të përshtatshme dhe dinjitoze. Ky vizion shtrihet për periudhën afatgjatë deri në vitin 2030 dhe synon të garantojë që strehimi të mos shihet vetëm si një nevojë bazë, por edhe si një element thelbësor për zhvillimin social, ekonomik dhe integrimin e plotë të grupeve vulnerabël në jetën e qytetit.

*Në këtë kuadër, Bashkia Malësi e Madhe synon:*

- Të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme dhe të përballeshme për strehim, në përputhje me mundësitë ekonomike të familjeve;
- Të garantojë përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël, duke reduktuar përjashtimin dhe diskriminimin;



- Të përdorë në mënyrë efektive burimet e disponueshme të territorit (banesa ekzistuese, troje potenciale, procesin e legalizimit);
- Të nxisë partneritetin me qeverinë qendrore, donatorët dhe sektorin privat për sigurimin e fondeve dhe zbatimin e programeve të reja të strehimit;
- Të ndërtojë një sistem monitorimi dhe transparence që garanton llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm të shërbimeve të strehimit social.

Ky vizion shërben si bazë orientuese për hartimin dhe zbatimin e Programit 5-vjeçar të Strehimit Social (2026–2030), duke e vendosur Bashkinë Malësi e Madhe në një rrugë zhvillimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në përputhje me politikat kombëtare të strehimit dhe me objektivat afatgjata të zhvillimit të qëndrueshëm.

### 3.2 Objektivat Strategjike dhe të Veçanta

Analiza e gjendjes së strehimit në Bashkinë Malësi e Madhe, mbështetur në të dhënat e Censit 2023 dhe të Regjistrit të Gjendjes Civile, ka treguar se nevojat për strehim social dhe të përballueshëm ndryshojnë në varësi të strukturës demografike, nivelit të të ardhurave, gjendjes së stokut ekzistues të banesave dhe shpërndarjes së shërbimeve publike. Për këtë arsye, hartimi i këtij Programi 5-vjeçar është orientuar nga parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe është ndërtuar në përputhje me Udhëzuesin për Planet Vendore të Strehimit, hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Në këtë kuadër, janë përcaktuar objektiva strategjike (me fokus afatmesëm, për 5–10 vjet) dhe objektiva të veçanta (me fokus afatshkurtër, brenda periudhës 5-vjeçare të planit), të cilat reflektojnë prioritetet e Bashkisë Malësi e Madhe për qiratë e subvencionuara, proceset e legalizimit, vënien në dispozicion të truallit dhe mbështetjen e grave të dhunuara e grupeve vulnerabël, duke u mbështetur gjithashtu në partneritete me qeverinë qendrore dhe burime të jashtme financiare.

#### *Objektivat Strategjike*

1. Sigurimi i aksesit në strehim të përballueshëm përmes programeve të qirasë së subvencionuar dhe mbështetjes së familjeve me të ardhura të ulëta;
2. Vënia në dispozicion e truallit publik për zhvillimin e projekteve të strehimit social, në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave dhe partnerë të tjerë;
3. Përmirësimi i sigurisë juridike të banimit përmes proceseve të legalizimit dhe formalizimit të banesave ekzistuese;
4. Mbështetja e grave viktime të dhunës në familje dhe e grupeve vulnerabël përmes programeve të dedikuara të strehimit;
5. Forcimi i partneriteteve me qeverinë qendrore, donatorët dhe sektorin privat për mobilizimin e burimeve financiare dhe teknike në funksion të programeve të strehimit.

#### *Objektivat e Veçanta*



- Zbatimi i programit të qirasë së subvencionuar për familjet me të ardhura të ulëta;
- Përdorimi i trojeve publike në pronësi të bashkisë ose EKB-së për ndërtimin e banesave sociale;
- Mbështetja e procesit të legalizimit dhe formalizimit të banesave për familjet në nevojë;
- Ndërtimi dhe vënia në dispozicion i banesave të specializuara për kategori të veçanta (gratë viktimat të dhunës, PAK, të moshuarit, viktimat e trafikimit, të rinjtë pas 18 vjeç);
- Rehabilitimi i banesave ekzistuese të amortizuara për përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat periferike dhe rurale;
- Nxitja e partneriteteve publike-private për ndërtimin e banesave të përballeshme;
- Zbatimi i programeve për strehim të përkohshëm në raste emergjencas.

Objektivat strategjike dhe të veçanta të Planit Vendor të Strehimit për Bashkinë Malësi e Madhe ofrojnë një kornizë të qartë veprimi, të bazuar në analizën e situatës lokale, të dhënat e Censit 2023 dhe të Regjistrit të Gjendjes Civile, si dhe në përputhje me Ligjin nr. 22/2018 dhe udhëzuesin përkatës.

Ato synojnë jo vetëm përmirësimin e kushteve të banimit dhe rritjen e aksesit në programe sociale, por edhe integrimin e strehimit me zhvillimin urban, shërbimet dhe tregun e punës.

Ky kombinim i vizionit afatgjatë me objektivat strategjike dhe të veçanta afatshkurtra e bën planin të zbatueshëm, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt qëndrueshmërisë, duke siguruar që askush të mos mbetet pas.

### 3.3. Plani i Zbatimit të Programit për Strehimin Social në Bashkinë Malësi e Madhe

Në kuadër të **Planit Vendor të Strehimit 2026–2030**, Bashkia Malësi e Madhe ka përcaktuar programet prioritare të strehimit që do të zbatohen gjatë periudhës së planit, në përputhje me **Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”** dhe me **Udhëzuesin për planet vendore të strehimit**, të miratuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave me asistencën teknike të partnerëve ndërkombëtarë.

Këto programe përfaqësojnë instrumente të integruara ndërhyrjeje, të cilat synojnë të mbështesin familjet dhe individët në nevojë, të përmirësojnë kushtet e banimit ekzistues, si dhe të krijojnë mundësi të reja për strehim social dhe të përballeshëm. Përzgjedhja e tyre është bërë mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe prioriteteve strategjike të Bashkisë Malësi e Madhe, duke u lënë hapësirë fleksibilitetit për t’u përshtatur sipas nevojave konkrete të komunitetit.



## Analiza e Programeve të Strehimit në Bashkinë Malësi e Madhe

Programi i strehimit	Përshkrimi	Objektivat kryesore	Grupet përfituese	Mekanizmat e zbatimit	Burimet e financimit	Statusi aktual në Bashki
<b>Qira Sociale/Bonus Strehimi</b>	Vendosja në dispozicion e banesave me qira të subvencionuar	Sigurimi i banesave të përballesh me për familjet vulnerabël	Familjet me të ardhura të ulëta; gratë e divorcuara; viktimat e dhunës; PAK	Përzgjedhja sipas kriterëve ligjore; kontrata qiraje të subvencionuara	Buxheti vendor; buxheti i shtetit; donatorë	Zbatohet aktualisht, në nivel vendor, për familjet me më shumë nevojë në Bashkinë Malësi e Madhe
<b>Banesa me kosto të ulët</b>	Ndërtimi ose blerja e banesave me çmim më të ulët se tregu	Rritja e aksesit në banesa për familjet me të ardhura të ulëta dhe të rinjtë	Të rinjtë; çiftet e reja; familjet në ndihmë ekonomike	Program bashkëfinancimi;	Buxheti i shtetit; buxheti vendor; partnerë privatë	Ende nuk është zbatuar në nivel vendor; mbetet projekt në planifikim
<b>Banesa të përkohshme</b>	Strehim emergjent për individë/familje që mbeten pa banesë	Sigurimi i strehimit të menjëhershëm/emergjent	Viktimat e dhunës; të prekurit nga fatkeqësitë natyrore; individët në krizë	Vendosje në struktura të Bashkisë ose marrëveshje me institucione të tjera	Buxheti vendor; fondi i emergjencave; OJF	Rastet trajtohen vetëm pjesërisht për viktimat e dhunës; nuk ka kapacitete të dedikuara
<b>Banesa të specializuara</b>	Banesa të përshtatura për persona me nevoja specifike	Ofrimi i kushteve sipas standardeve	PAK; të moshuarit e vetmuar; viktimat dhune/trafikimi	Rikonstruksion/përshtatje banesash; ndërtim i ri	Buxheti vendor; shteti; donatorë	Nuk ka projekte të dedikuara në zbatim; vetëm mbështetje rast pas rasti për gratë e dhunuara
<b>Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese</b>	Rikonstruksion dhe përshtatje infrastrukturore	Rritja e cilësisë së jetesës	Familje të varfra; PAK; familje me shumë fëmijë	Subvencione dhe projekte bashkëfinancuese	Buxheti vendor; shteti; BE/UNDP	Nuk zbatohet aktualisht; disa kërkesa janë evidentuar, por presin mbështetje
<b>Zhvillimi i zonës për qëllim strehimi</b>	Ndërtim lagjesh sociale në tokën e Bashkisë	Krijimi i stokut të ri të banesave sociale	Familje në nevojë; komuniteti rom; çiftet e reja	Projekte ndërtimi me qeverinë qendrore/privatët	Enti i Banesave, Donatorë +Shteti	Në fazë planifikimi; nuk ka ende zbatim konkret

Zbatimi i këtyre programeve në Bashkinë Malësi e Madhe gjatë periudhës 2026–2030 do të krijojë një mekanizëm të balancuar midis mbështetjes sociale, përmirësimit të kushteve ekzistuese të banimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban. Secili program mbart një rol të veçantë në adresimin e nevojave të ndryshme të qytetarëve, duke garantuar që asnjë kategori e komunitetit të mos mbetet jashtë mbështetjes. Përmes kombinimit të burimeve vendore dhe qendrore, si dhe bashkëpunimit me aktorë privatë dhe partnerë ndërkombëtarë, Bashkia Malësi e Madhe synon të sigurojë jo vetëm strehim të përballeshëm, por edhe një standard më të lartë jetese për të gjitha familjet dhe individët në nevojë, në përputhje me objektivat strategjike të këtij programi 5-vjeçar.



#### 4. Plani i Veprimit për Programet e Strehimit Social 2026–2030

Plani i Veprimit i Bashkisë Malësi e Madhe për periudhën 2026–2030 fokusohet në projekte prioritare që adresojnë nevojat më urgjente të komunitetit dhe garantojnë akses në strehim social të sigurt, të përballueshëm dhe dinjitoz. Përzgjedhja e projekteve është bazuar në:

- analizën e gjendjes aktuale të strehimit;
- objektivat strategjike të planit;
- potencialin e burimeve financiare dhe të partneriteteve me aktorë publikë e privatë.

Këto projekte përfaqësojnë ndërhyrjet më të rëndësishme për të mbështetur grupet vulnerabël dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe

#### Analiza Strategjike e Projekteve Prioritare për Strehimin Social në Bashkinë Malësi e Madhe

Programi / Projekti	Përshkrimi	Objektivat Kryesore	Grupi Përfitues	Statusi / Kapaciteti	Mbështetja / Burimet Financiare
<b>Programi për Zhvillimin e Zonave të Reja me Qëllim Strehimin</b>	Planifikim dhe ndërtim lagjesh sociale me infrastrukturë shoqëruese.	Urbanizim i qëndrueshëm dhe krijim i stokut të ri të banesave sociale.	Familje në nevojë; komunitete vulnerabël; çiftet e reja; komuniteti rom.	Në proces planifikim; kapacitet afatgjatë, ku do të akomodohen 20 familje të pastreha	Buxheti i Bashkisë; Qeveria Qendrore; Enti i Banesa.
<b>Programi i Bonusit të Strehimit/Qira Sociale</b>	Subvencion financiar mujor për pagesën e qirasë si masë kompensimi.	Sigurimi i strehimit të përkohshëm dhe të përballueshëm për familjet e prekura nga projektet publike ose fatkeqësitë.	Familje me të ardhura të ulta, familjet e pastreha,	Aktiv; po zbatohet për 15 familje.	Buxheti i Bashkisë.
<b>Programi i Subvencionimit të Kredisë së Butë</b>	Subvencionimi i interesave me kredi hipotekore të marra nga familje ose individë që nuk kanë mundësi të sigurojnë një banesë në tregun e lirë, duke ulur barrën financiare	Lehtësimi i aksesit në pronësi banese për të rinjtë, çiftet e reja dhe familjet me të ardhura të ulta, përmes subvencionimit të normës së interesit.	Të rinj 18-34 vjeç, çiftet e reja pa banesë në pronësi-	Në proces, nga 21 aplikime, 6 janë të miratuar, 4 janë në pritje, pjesa tjetër është refuzuar për mungesë kriteresh.	Qeveria Qendrore(subvencionimi i interesit)Banka e nivelit të dytë(dhënie e kredisë)Bashkia Malësi e Madhe(mbështetje teknike dhe asistencë për aplikime)



Ky format analitik siguron një bazë të qartë për menaxhimin dhe prioritizimin e projekteve, duke u fokusuar te ndikimi i drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të banimit. Secili projekt është konceptuar për të adresuar një kategori specifike të popullsisë dhe për të mbushur boshllëqet ekzistuese në infrastrukturën e strehimit, duke u shndërruar kështu në një mjet praktik për zbatimin e politikave sociale.

**Banesat sociale dhe me kosto të ulët** përbëjnë shtyllën kryesore të planit, pasi garantojnë strehim të përballueshëm për familjet me ndihmë ekonomike dhe të rinjtë që krijojnë familje të reja. Këto projekte, të cilat janë aktualisht në fazë planifikimi me Entin e Banesave, pritet të shërbejnë si një investim afatgjatë dhe i qëndrueshëm në uljen e numrit të familjeve pa banesë.

**Përmirësimi i kushteve ekzistuese të banesave** është një ndërhyrje e domosdoshme, duke pasur parasysh se shumë banesa në Malësi e Madhe janë ndërtuar para viteve '90 dhe nuk i përmbushin standardet minimale të sigurisë dhe eficiencës energjetike. Përfituesit kryesorë janë familjet e varfra dhe personat me aftësi të kufizuara, ndërsa realizimi i këtij projekti mbetet i varur nga mbështetja e shtetit dhe donatorëve, pasi aktualisht nuk po zbatohet.

**Banesa të përkohshme** janë një nevojë e vazhdueshme për të menaxhuar raste emergjente, si fatkeqësitë natyrore apo dhuna në familje. Bashkia Malësi e Madhe ka ofruar mbështetje në këtë drejtim, por kapacitetet janë ende të kufizuara dhe kërkohet forcim i mekanizmave për reagim të shpejtë, në bashkëpunim me institucionet e emergjencave dhe partnerët ndërkombëtarë.

**Banesa të specializuara** janë një risi e rëndësishme e këtij plani, të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit që kanë nevojë për kujdes të veçantë. Aktualisht ky projekt është në diskutim, por ka potencial për t'u shndërruar në një element kyç për ofrimin e një strehimi dinjitoz dhe të përshtatur sipas standardeve të aksesueshmërisë. Mbështetja e shtetit dhe partnerëve socialë është vendimtare për zbatimin e tij.

**Zhvillimi i zonave sociale** përfaqëson një vizion afatgjatë për urbanizim të qëndrueshëm dhe të planifikuar. Këto projekte nuk ofrojnë vetëm banesa, por edhe infrastrukturë shoqërore (shkolla, çerdhe, qendra shëndetësore), duke synuar krijimin e lagjeve funksionale dhe me cilësi të lartë jetese për familjet në nevojë.


Në tërësi, analiza strategjike tregon se Bashkia Malësi e Madhe ka identifikuar qartë prioritetet dhe ka ndërtuar një plan të balancuar midis ndërhyrjeve afatshkurtra (si qiratë sociale dhe banesat e përkohshme) dhe zgjidhjeve afatgjata (si ndërtimi i zonave sociale dhe banesave të reja me kosto të ulët). Për të siguruar suksesin e planit, është thelbësore që secili projekt të shoqërohet me tregues matës të qartë (numrin e familjeve të përfituara, fondet e angazhuara dhe përparimin e zbatimit), duke garantuar transparencë dhe qëndrueshmëri në kohë.

## **Përshkrimi i Zonës së Zhvillimit për Strehim Social**



Pas analizës së projekteve prioritare, në hartën e vendosur paraqitet një nga ndërhyrjet kyçe: ndërtimi i një objekti multifunksional banim dhe shërbimesh në pronen 7/10 me sipërfaqe totale 814 m<sup>2</sup> në ZK 2220, në pronë të Bashkisë Malësi e Madhe.

- **Karakteristikat teknike dhe urbanistike:**
- Njesia Strukturore KO\_03-A12-14 me nënkategori A1-zona banimi urbane
- Sipërfaqja totale e zonës për zhvillim: 814 m<sup>2</sup>
- Sipërfaqja e ndërtuar: 137 m<sup>2</sup>
- Koeficienti i shfrytëzimit të truallit: 40%
- Intensiteti i ndërtimit: 1
- Numri i kateve mbi tokë të lejuar: 3 kat
- Numri i kateve nën tokë: -
- Distancat nga rruga dhe kufijtë e pronës: të përcaktuara sipas normave urbanistike, duke siguruar harmonizimin me mjedisin përreth.
- Bashkangjitur do të gjeni foto ilustruese nga e-planifikimi për zonen e lartpërmendur.



Qëllimi i projektit:



1. Sigurimi i banesave sociale dhe shërbimeve të nevojshme për familjet dhe individët në nevojë.
  2. Mbështetja e grupeve të vulnerabël, përfshirë familjet me të ardhura të ulëta, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe persona me aftësi të kufizuara.
  3. Promovimi i zhvillimit urban të qëndrueshëm, duke integruar ndërhyrjen e re në mjedisin ekzistues dhe duke rritur cilësinë e hapësirave publike.
- Rrit kapacitetet strehimore të Bashkisë Malësi e Madhe duke plotësuar nevojat emergjente dhe afatgjata për strehim social.
  - Përmirëson standardin e jetesës dhe siguron akses në shërbime sociale të integruara.
  - Ndihmon në menaxhimin e zhvillimit urban në mënyrë të planifikuar dhe të qëndrueshme, duke shmangur ndërhyrjet spontane dhe mbingarkimin e infrastrukturës ekzistuese

### **Përputhshmëria me Planin e Strehimit Social:**

Ky objekt shërben si një shembull konkret i qasjes së Bashkisë Malësi e Madhe për të integruar **planifikimin urban me prioritetet sociale**, duke siguruar një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve dhe duke lehtësuar monitorimin e rezultateve për periudhën 2026–2030.

Ky projekt përfaqëson një ndërhyrje prioritare në kuadër të Planit 5-vjeçar të Strehimit Social 2026–2030, të parashikuar nga Bashkia Malësi e Madhe në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave të planifikuar, të harmonizuar me udhëzimet e Bashkisë Malësi e Madhe dhe standardet e përcaktuara për **planifikimin dhe zhvillimin e strehimit social**. Ai tregon qasjen integruese të bashkisë, duke lidhur planifikimin urban me prioritetet sociale dhe duke mundësuar monitorimin e rezultateve për periudhën **2026–2030**. Implementimi i tij siguron një ndikim të qëndrueshëm dhe të matshëm në përmirësimin e kushteve të jetesës për komunitetin, duke respektuar normat ligjore dhe urbanistike të vendit.



Harta orientuese e territorit në funksion të Planit të Strehimit Social

Harta e mëposhtme paraqet shpërndarjen funksionale të territorit të Bashkisë, ku identifikohen zonat urbane, rurale, industriale, bujqësore, pyjore dhe ato me destinacion të veçantë. Në kuadër të Planit të Strehimit Social, kjo paraqitje vizuale është një element kyç për të kuptuar vendndodhjen e infrastrukturës ekzistuese, hapësirave të lira ndërtimore dhe lidhjen e tyre me rrjetin rrugor, shërbimet publike dhe zonat me potencial zhvillimi. Përmes saj bëhet e mundur të vlerësohen mundësitë për vendosjen e projekteve të reja të strehimit social në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme.

Kjo hartë shërben si një instrument i rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e politikave të strehimit social në Bashki, duke ndihmuar në identifikimin e zonave më të përshtatshme për ndërhyrje dhe investime. Ajo krijon një bazë të qartë orientimi për përzgjedhjen e lokacioneve të banesave sociale, duke marrë në konsideratë aksesin në shërbime, transport dhe infrastrukturë publike. Në këtë mënyrë, Plani i Strehimit Social mbështetet mbi një qasje të integruar të zhvillimit hapësinor, me synim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe garantimin e barazisë sociale për të gjithë qytetarët.



## 4.2 Kostot e Përafërta

### 4.2.1 Kostot e Përafërta të Projekteve Prioritare

Vlerësimi i kostove të përafërta për projektet prioritare të strehimit social është një element thelbësor për planifikimin e buxhetit vendor dhe për koordinimin me fondet e qeverisë qendrore, donatorëve dhe partnerëve zhvillimorë. Sipas Udhëzuesit për Planet Vendore të Strehimit, ky vlerësim duhet të shërbejë si bazë për:

- **Përcaktimin e masës së burimeve financiare** që duhet të angazhohen gjatë periudhës 2026–2030;
- **Planifikimin afatmesëm buxhetor** të bashkisë;
- **Vlerësimin e alternativave të bashkëfinancimit** me sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë;
- **Shmangien e vonesave në implementim**, duke pasur një strukturë të qartë të kostove për çdo program.

### Korniza Institucionale e Kostove të Përafërta për Projektet Prioritare

Projekti / Programi Prioritar	Përshkrimi i Shkurtër	Roli i Bashkisë Malësi e Madhe	Roli i Buxhetit të Shtetit	Roli i Partnerëve të Tjerë	Periudha e Zbatimit
<b>Banesa Sociale me Kosto të Ulët</b>	Ndërtim i njëjive të reja banimi me qira të subvencionuar për familjet me të ardhura të ulëta. Në këtë kuadër parashikohet ndërtimi objekteve me apartamente për familje në nevojë, si një program i ri që do të implementohet për herë të parë në Bashkinë Malësi e Madhe.	Vendos truallin në dispozicion; mbulon infrastrukturën ndihmëse lokale	Siguron fondet për ndërtimin e banesave sociale me kosto të ulët.	Donatorë ndërkombëtarë; Partneritete Publike-Private.	2026–2030
<b>Përmirësimi i banesave ekzistuese</b>	Rikonstruksion, izolim termik dhe përshtatje infrastrukturore për banesa të amortizuara. Deri tani janë evidentuar 5 kërkesa konkrete për rikonstruksion.	Identifikon familjet përfituese; bashkëfinanco n ndërhyrjet.	Financon programet kombëtare të rehabilitimit.	BE, UNDP dhe donatorë të tjerë.	2026–2030
<b>Bonusi i Strehimit/Qira Sociale</b>	Subvencion financiar mujor për pagesën e qirasë për familjet në	Evidenton dhe miraton përfituesit;	Jep mbështetje financiare shtesë për	Qeveria qendrore; donatorë për	2026–2030



	nevojë. Aktualisht 15 familje në Malësi e Madhe përfitojnë 10.000 lekë/muaj.	mbulon pjesërisht pagesën mujore.	subvencionin.	mbështetje teknike.	
<b>Banesa të Përkohshme</b>	Strehim emergjent për familje dhe individë në situata të jashtëzakonshme (dhunë, fatkeqësi natyrore).	Menaxhon dhe mbështet rastet urgjente; vendos në dispozicion struktura publike.	Siguron fond nga fondi i emergjencave qendrore.	Donatorë dhe OJF për shërbime shtesë.	2026–2030
<b>Banesa të Specializuara</b>	Banesa të përshtatura për PAK, të moshuar, viktima dhune/trafikimi. Nga 20 raste të dhunës të evidentuara në Bashki, një pjesë janë trajtuar me mbështetje emergjente.	Vë në dispozicion truall ose ambiente ekzistuese për përshtatje.	Mbështetje e kufizuar nga programe specifike.	Partnerë socialë, OJF dhe donatorë.	2026–2030

Ky vlerësim i kostove të projekteve prioritare të strehimit social për periudhën 2026–2030 në Bashkinë Malësi e Madhe përfaqëson një instrument financiar dhe një mjet planifikimi strategjik, në përputhje me objektivat e Planit dhe prioritetet kombëtare të përcaktuara në Strategjinë e Strehimit Social. Prioritet i veçantë i është dhënë ndërtimit të banesave sociale dhe me kosto të ulët, si ndërhyrje afatgjata që synojnë uljen e numrit të familjeve të pastreha dhe rritjen e aksesit në strehim të përballeshëm për familjet me të ardhura të ulëta, të rinjtë dhe grupet vulnerabël. Një komponent tjetër i rëndësishëm është përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e stokut është ndërtuar para viteve '90 dhe nuk i përmbush standardet minimale të sigurisë dhe efikasitetit energjetike. Bonusi i strehimit mbetet një mekanizëm i shpejtë dhe fleksibël, aktualisht i aplikuar për 15 familje me një mbështetje prej 10.000 lekë/muaj, duke garantuar një formë të qëndrueshme të strehimit të përkohshëm. Po ashtu, banesat e përkohshme dhe të specializuara janë të domosdoshme për adresimin e emergjencave dhe situatave të veçanta sociale, si dhuna në familje apo nevojat e personave me aftësi të kufizuara, megjithëse kërkojnë forcim të kapaciteteve financiare dhe institucionale. Ndërhyrjet afatgjata, si zhvillimi i zonave sociale me infrastrukturë të integruar, lidhen ngushtë me Planin e Përgjithshëm Vendor, duke kontribuar në parandalimin e ndërtimit informal dhe në krijimin e një zhvillimi urban të qëndrueshëm. Për zbatimin e këtyre projekteve madhore kërkohet mbështetje e drejtpërdrejtë nga Qeveria Qendrore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Enti Kombëtar i Banesave, si dhe angazhimi i partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile, në mënyrë që të sigurohet një qasje gjithëpërfshirëse, transparente dhe e matshme, e cila forcon kohezionin social dhe përmirëson kushtet e jetesës për komunitetin e Bashkisë Malësi e Madhe.



### 4.3 Burimet e Financimit

**Bashkia Malësi e Madhe do të vendosë që 2% e buxhetit të alokohen për zbatimin e Planit të Strehimit Social 2026–2030, duke krijuar një garanci të qëndrueshme financiare për projektet prioritare dhe duke forcuar bazën për mbështetje shtesë nga qeveria qendrore, Enti i Banesave, partnerët ndërkombëtarë dhe sektori privat.**

**Qëllimi kryesor (synimi) është të sigurohet që çdo program të ketë mbështetje të mjaftueshme financiare, duke reflektuar situatën aktuale dhe duke u orientuar drejt mbulimit të nevojave në rritje për banesa sociale, banesa të specializuara, bonus strehimi dhe programe të tjera.**

#### *Projektet Prioritare dhe Burimet e Financimit (2026–2030)*

Programi / Projekti Prioritar	Përshkrimi	Grupi Përfitues & Situata Aktual	Burimet e Financimit	Periudha	Rezultat i synuar 2026-2030
<b>Banesa me Kosto të Ulët/ Bonusi i Strehimit</b>	Ndërtim banesash sociale me qira të subvencionuar ose me çmim të reduktuar.	Programi i cili po implementohet në Bashkinë Malësi e Madhe; përfituesit përcaktohen në bazë të aplikimeve dhe kriterëve të ligjit nr. 22/2018, me prioritet për familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet vulnerabël	. Bashkia (truall + infrastrukturë), Enti i Banesave (ndërtim), Donatorë	2026–2030	Krijimi i fondit fillestar të banesave sociale me kosto të ulët dhe akomodimi i një numri të konsiderueshëm familjesh sipas kriterëve ligjore, duke garantuar akses të drejtë dhe të barabartë. Rritje e mbulimit në 25–30 familje, me pagesë mujore të subvencionuar deri në nivelin e miratuar nga Këshilli Bashkiak, nga 15 familje përfitojnë bonus aktualisht, pritet rritje e kërkesës.
<b>Përmirësimi i Kushteve Ekzistuese</b>	Rikonstruksion, përshtatje strukturore dhe energjetike për banesa të amortizuara (para viteve '90).	5 kërkesa të evidentuara; gjendje e përhapur në zonat rurale.	Buxheti i Shtetit, Bashkia (identifikim & bashkëfinancim), Donatorë (BE, UNDP).	2026–2030	Rikonstruksion i 30 banesave në zonat me risk të lartë, duke përmirësuar kushtet e jetesës për familjet vulnerabël.
<b>Banesa të Përkohshme</b>	Vendosje në strehim emergjent për.shkak te	Rastet mbështeten nga Bashkia me kapacitete	Bashkia (qira sociale), Fondi i emergjencave shtetëror,	2026–2028	Strehim emergjent për të paktën 50 raste gjatë periudhës, me



	investimve publike ose private, emigrantë e kthyer, personat e pastrehë.	të kufizuara; pritet rritje për shkak të emergjencave.	Donatorë/OJF.		kapacitet për përgjigje brenda 30 ditëve nga emergjenca.
<b>Banesa të Specializuara</b>	Banesa të përshtatura për PAK, të moshuarit dhe viktimat e dhunës/trafikimit	Aktualisht vetëm mbështetje rast-pas-rasti; kërkesa në rritje.	Bashkia (truall/ambiente ekzistuese), Qeveria qendrore, Partnerë socialë & OJF.	2027–2030	Ndërtim ose përshtatje e 20 njësive banimi të specializuara me standarde aksesueshmërie dhe shërbime mbështetëse.
<b>Subvencionimi I interesave të Kredisë</b>	Mbështetja e të rinjve, familjeve të reja dhe familjet njëprindërore	Aktualisht janë akorduar 6 aplikante dhe 4 janë në fazë pritje	Buxheti i Shtetit+Ministria e Financave+Drejtoria e Srehimit Social.	2026–2030	Synohet rritja e aksesit për të paktën 50 familje të tjera, duke u bazuar në ecurinë aktuale dhe kapacitete e parashikuara nga programi.

Ky planifikim i integruar garanton një shpërndarje të qartë të përgjegjësisë dhe transparencë në përdorimin e fondeve. Ai krijon ekuilibër mes ndërhyrjeve emergjente (banesat e përkohshme dhe ato të specializuara) dhe projekteve afatgjata (banesat sociale me kosto të ulët dhe zhvillimi i zonave sociale), duke siguruar që komunitetet vulnerabël të kenë akses në banesa të sigurta, të përballeshme dhe dinjitoze për periudhën 2026–2030.

Ky planifikim financiar i integruar synon të **balancojë ndërhyrjet emergjente** (banesat e përkohshme, bonus strehimi dhe banesat e specializuara) me **ndërhyrjet afatgjata** (banesat sociale me kosto të ulët dhe zhvillimi i zonave sociale).

- **Për banesat sociale**, synimi është të ulët hendeku mes kërkesës dhe ofertës aktuale, duke rritur gradualisht numrin e familjeve të akomoduara.
- **Për bonusin e strehimit**, parashikohet rritje progresive e kërkesave, e cila kërkon zgjerim të fondit nga Bashkia dhe qeveria qendrore.
- **Për banesat e specializuara**, synimi është kalimi nga mbështetje rastësore tek struktura të dedikuara dhe të qëndrueshme, duke u bazuar në partneritetet me OJF dhe donatorë.
- **Për zonat sociale**, synimi është krijimi i një fondi të ri banesash të përballeshme, të integruara me shërbime publike dhe infrastrukturë.

Në këtë mënyrë, burimet financiare dhe institucionale lidhen drejtpërdrejt me **synimin për të përmbushur nevojat në rritje** të komuniteteve vulnerabël, duke garantuar strehim të sigurt, të përballeshëm dhe dinjitoz për periudhën 2026–2030.



## 4.4 Afatet Kohore

Për zbatimin e projekteve të strehimit social në Bashkinë Malësi e Madhe, përcaktimi i afateve kohore është një element thelbësor për menaxhimin efikas të burimeve dhe koordinimin ndërinstitucional. Afatet shërbejnë për të strukturuar fazat e punës, për të shpërndarë kostot në mënyrë graduale dhe për të garantuar që çdo ndërhyrje të realizohet sipas prioriteteve të identifikuar dhe nevojave të komunitetit.

Në këtë kuadër, programet prioritare janë planifikuar në mënyrë të fazuar, duke kombinuar ndërhyrjet emergjente me ato afatgjata dhe duke siguruar një balancë mes përgjigjes së menjëhershme dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

*Pasqyra e Planifikimit Kohor të Programit të Strehimit Social (2026–2030)*

Projekti / Programi Prioritar	Periudha e Zbatimit	Fazimi / Përshkrimi i Veprimeve
Banesa Sociale / me Kosto të Ulët	2026–2030	Ndërtim në faza vjetore; fillimisht në zonat urbane me presion më të lartë për banesa (Malësi e Madhe, Xhafzotaj), më pas zgjerim në njësitë rurale.
Përmirësimi i kushteve ekzistuese	2026–2030	Ndërhyrje graduale në stokun ekzistues; nis me banesat me risk të lartë strukturor dhe energjetik, më pas zgjerim në zonat periferike dhe rurale.
Banesa të Përkohshme	2026–2028	Vendosje në përdorim për raste urgjente (fatkeqësi natyrore, sociale, dhunë); fazë e kufizuar me mbështetje të menjëhershme.
Banesa të Specializuara	2026–2030	Ndërtim dhe përshtatje banesash për kategori të veçanta (PAK, të moshuar, viktime dhune); faza fillestare në qytet, më pas zgjerim në zona rurale.
Zhvillimi i Zonave Sociale	2026–2030	Faza përgatitore (2026–2027) për planifikim dhe urbanizim; faza ndërtimore (2028–2030) për krijimin e lagjeve sociale me infrastrukturë të integruar.
Bonus Strehimi për Përfituesit e vecantë	2026–2028	Subvencion financiar mujor për pagesën e qirasë; faza fillestare për familjet e prekura nga projekte publike; monitorim dhe vlerësim i vazhdueshëm për mbështetje të qëndrueshme.
Programi i Subvencionimit të Kredive të Buta	2026–2030	Dhënie e kredive hipotekore me interesa të subvencionuara për familjet e kualifikuara; faza fillestare për përfituesit aktualë (2025–2026), më pas zgjerim sipas kërkesës dhe kapacitetit të Bashkisë Malësi e Madhe dhe bankave partner.

Plani kohor i mësipërm është i ndërtuar mbi parimin e fazimit: projektet që adresojnë nevoja emergjente (banesat e përkohshme dhe përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese) vendosen në fillim të periudhës, për të përballuar urgjencat aktuale dhe për të ofruar siguri bazike qytetarëve. Në vijim, ndërhyrjet afatgjata, si ndërtimi i banesave sociale, banesave të specializuara dhe zhvillimi i zonave të reja, shtrihen përgjatë gjithë periudhës 2026–2030. Kjo shpërndarje kohore siguron një proces të kontrolluar, të harmonizuar me burimet financiare dhe institucionale, duke mundësuar jo vetëm përmirësim të menjëhershëm të kushteve të jetesës, por edhe ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të strehimit social në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe



Plani kohor i mësipërm reflekton një qasje të fazuar dhe të integruar. Projektet që adresojnë nevoja emergjente, si banesat e përkohshme dhe përmirësimi i kushteve të stokut ekzistues, vendosen në vitet e para të planit për të përballuar urgjencat aktuale. Ndërkohë, projektet afatgjata si ndërtimi i banesave sociale, banesave të specializuara dhe zhvillimi i zonave të reja për strehim, shpërndahen në gjithë periudhën 2026–2030 për të garantuar një zbatim të qëndrueshëm dhe të planifikuar. Kjo qasje lejon Bashkinë Malësi e Madhe të menaxhojë gradualisht kostot, të përfshijë burime shtesë financimi dhe të rrisë kohezionin social përmes përmirësimit të kushteve të banimit në të gjithë territorin.

#### 4.5 Treguesit e Monitorimit.

Monitorimi i Programit 5-vjeçar të Strehimit Social në Bashkinë Malësi e Madhe bazohet në një grup treguesish të matshëm, që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e vendosura dhe projektet prioritare. Këta tregues shërbejnë për të matur progresin, për të vlerësuar efikasitetin e përdorimit të burimeve dhe për të orientuar ndërhyrjet korigjuese aty ku është e nevojshme. Ato përfshijnë elementë sasiorë (numra, përqindje, fonde) dhe cilësorë (përmirësim i kushteve të banimit, kënaqësia e përfituesve).

Programi / Projekti Prioritar	Treguesi i Monitorimit	Njësia e Matjes	Frekuenca e Matjes	Institucioni Përgjegjës
<b>Banesa Sociale / me Kosto të Ulët</b>	Numri i banesave të ndërtuara / familjeve të akomoduar	Nr. banesash / familjesh	Vjetor	Bashkia Malësi e Madhe, EKB
<b>Përmirësimi i kushteve ekzistuese</b>	Numri i banesave të rikonstruara / përshtatura	Nr. banesash	Vjetor	Bashkia Malësi e Madhe, Donatorë
<b>Bonusi i Strehimit</b>	Numri i familjeve përfituese dhe vlera mesatare e bonusit	Nr. familjesh / lekë/muaj	6-mujor	Bashkia Malësi e Madhe
<b>Banesa të Përkohshme</b>	Numri i rasteve emergjente të trajtuara me strehim afatshkurtër	Nr. familjesh / raste	Periodik	Bashkia Malësi e Madhe, Qeveria Qendrore
<b>Banesa të Specializuara</b>	Numri i banesave të përshtatura për PAK / viktimë dhune	Nr. banesash / raste	Vjetor	Bashkia Malësi e Madhe, OJF
<b>Zhvillimi i Zonave Sociale</b>	Sipërfaqja e truallit të urbanizuar dhe numri i familjeve të akomoduar	Ha / nr. familjesh	Vjetor	Bashkia Malësi e Madhe, Qeveria Qendrore
<b>Burimet e Financimit</b>	Shuma e fondeve të disbursuara sipas projekteve	Lekë / % e realizimit	6-mujor	Drejtoria e Financës
<b>Kënaqësia e Përfituesve</b>	Përqindja e familjeve që raportojnë përmirësim të kushteve të banimit	%	Vjetor	Sektori i Shërbimeve Sociale

Përcaktimi i këtyre treguesve siguron që zbatimi i Programit të Strehimit Social 2026–2030 të mbështetet mbi rezultate të matshme dhe të verifikueshme. Matja periodike e numrit të banesave të ndërtuara, familjeve të mbështetura me bonus, fondeve të disbursuara dhe përmirësimit të kushteve të jetesës do të garantojë transparencë dhe efikasitet. Në të njëjtën kohë, vlerësimi i kënaqësisë së përfituesve dhe konsultimet publike do të forcojnë dimensionin social dhe gjithëpërfshirës të planit. Kështu, treguesit e monitorimit shndërrohen në një mekanizëm vendimmarrës, që i lejon Bashkisë Malësi e Madhe të korigjojë, përmirësojë dhe përshtasë ndërhyrjet sipas nevojave reale të komunitetit

Pasqyra e Treguesve të Monitorimit të Programeve të Strehimit Social 2026–2030



Treguesi	Institucioni Përgjegjës	Burimi i Financimit	Rezultati i Synuar 2030	Frekuenca e Matjes
Numri total i familjeve të pastreha	Bashkia Malësi e Madhe	Buxheti i shtetit, Donatorë	Ulje progresive e numrit të familjeve të pastreha në territor	Vjetore
Funksionimi i sistemit për grumbullimin e të dhënave	Bashkia Malësi e Madhe	Buxheti vendor, Donatorë (teknologji dhe asistencë)	Sistemi elektronik funksional, i azhurnuar dhe i aksesueshëm për raportim	Vjetore
Përqindja e aplikantëve që përfitojnë nga programet	Bashkia Malësi e Madhe	Buxheti vendor, Buxheti i shtetit, OJF	Rritje graduale e përfituesve në raport me aplikimet totale	Vjetore
Numri i familjeve që përfitojnë nga përmirësimi i kushteve të banesave	Bashkia Malësi e Madhe	Buxheti vendor, Buxheti i shtetit, Donatorë	Mbështetje e vazhdueshme për familje vulnerabël dhe banesa të amortizuara	Vjetore
Numri i familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë (bonusi i strehimit)	Bashkia Malësi e Madhe	Buxheti vendor (pjesa kryesore), Buxheti i shtetit	Rritje progresive e numrit të familjeve të mbuluara me bonus qiraje	Vjetore
Rritja e fondit të banesave sociale (pronarë socialë)	Bashkia Malësi e Madhe	Buxheti vendor, OJF, Partnerë privatë	Krijimi i një fondi aktiv të banesave sociale në territor	Vjetore
Mbështetja për PAK përmes programeve të dedikuara (BSQ, banesa të specializuara)	Bashkia Malësi e Madhe	Buxheti vendor, Buxheti i shtetit, OJF, Donatorë	Rritje e mbulimit me strehim dhe përshtatje për PAK	Vjetore

Treguesit e mësipërm do të shërbejnë si bazë për raportimin periodik të ecurisë së programeve dhe për matjen e impaktit të tyre në cilësinë e jetës së qytetarëve. Për secilin tregues do të përcaktohen burimet e të dhënave, metodologjia e mbledhjes dhe mekanizmat e raportimit, në mënyrë që procesi i monitorimit të jetë sa më transparent dhe i besueshëm. Përveç raportimit vjetor, parashikohet edhe një rishikim i ndërmjetëm i objektivave (midterm revieë), që do të ndihmojë në përshtatjen e politikave sipas realiteteve dhe sfidave që mund të shfaqen gjatë periudhës së zbatimi.



## 5. Zbatimi dhe Monitorim

### 5.1 Institucionet Përgjegjëse

Zbatimi i Programit 5-vjeçar të Strehimit Social për Bashkinë Malësi e Madhe mbështetet në një strukturë të qartë institucionale, ku secili institucion ka rol dhe përgjegjësi të përcaktuara për koordinimin, menaxhimin financiar, monitorimin ligjor dhe mbështetjen sociale. Ky organizim siguron bashkërendim ndërsektorial, përdorim efikas të burimeve dhe transparencë në çdo fazë të procesit.

<b>Institucioni</b>	<b>Roli dhe Përgjegjësitë</b>
<b>Bashkia Malësi e Madhe</b>	Koordinon procesin e përgjithshëm; mbikëqyr në nivel strategjik; siguron zbatimin në përputhje me programin e miratuar.
<b>Drejtoria Juridike</b>	Siguron përputhshmërinë ligjore të procedurave; harton kontratat; mbron interesin publik në zbatimin e projekteve; mbështet procesin e monitorimit dhe raportimit ligjor.
<b>Drejtoria e Shërbimeve Publike</b>	Menaxhon planin teknik të zbatimit; menaxhon projektet e ndërtimit dhe rikonstruksionit; monitoron infrastrukturën; përditëson databazat dhe sistemet online.
<b>Drejtoria e Financës</b>	Menaxhon buxhetin e programit; siguron ndarjen e fondeve sipas prioriteteve; raporton mbi ecurinë financiare.
<b>Spektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale</b>	Zbaton programet sociale të lidhura me strehimin; asiston familjet përfutuese; mbledh të dhëna për monitorim; përgatit raportime mbi rastet.
<b>Enti Kombëtar i Banesave (EKB)</b>	Partner strategjik për ndërtimin e banesave sociale; bashkëpunon për identifikimin e trojeve dhe zhvillimin e projekteve prioritare.
<b>Qeveria Qendrore</b>	Siguron mbështetjen financiare për programet kombëtare; menaxhon fondet e emergjencës; forcon partneritetet ndërinstitutionale.
<b>OJF dhe partnerë zhvillimi</b>	Ofron mbështetje teknike dhe financiare; kontribuon në ndërgjegjësimin e komunitetit; monitoron me qasje të pavarur dhe plotësuese.

Ky strukturim institucional siguron që çdo hallkë të ketë përgjegjësi të qarta dhe të ndërveprojë ngushtë me të tjerat. Përmes këtij mekanizmi, Bashkia Malësi e Madhe synon të krijojë një proces të koordinuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për zbatimin e Programit 5-vjeçar të Strehimit Social, duke garantuar transparencë, efikasitet dhe arritjen e objektivave strategjike

### 5.2 Proçesi i Monitorimit dhe Raportimit

Proçesi i monitorimit dhe raportimit për Programin 5-vjeçar të Strehimit Social 2026–2030.përcakton mënyrat kryesore për ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të programeve të strehimit social 2026–2030 në Bashkinë Malësi e Madhe. Qëllimi është të garantohet mbikëqyrje e vazhdueshme, raportim i saktë dhe koordinim ndërinstitutional, në mënyrë që çdo projekt të realizohet sipas objektivave të përcaktuara dhe të sigurojë rezultate të matshme për komunitetin.



## Instrumenti i Monitorimit dhe Ndjekjes së Projekteve të Strehimit Social

Mekanizmi	Përshkrimi	Frekuenca	Institucioni Përgjegjës
Grumbullimi i të dhënave	Evidentimi i të dhënave për secilin projekt dhe program, përfshirë numrin e përfituesve, fondet e përdorura dhe ecurinë e zbatimit.	Periodik	Drejtoria Juridike; Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Ndihmës Ekonomike
Përditësimi i databazës dhe sistemeve online	Azhumimi i informacionit mbi grupet përfituese dhe statusin e projekteve në sistemet e menaxhimit.	Periodik	Drejtoria e Planifikimit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike; Drejtoria Juridike
Matja e treguesve kryesorë	Vlerësim i indikatorëve të performancës sipas objektivave të Programit 2026–2030 dhe afateve të përcaktuara.	Vjetore	Bashkia Malësi e Madhe; Drejtoria Juridike
Përgatitja e raporteve vjetore	Hartimi i raporteve mbi progresin, fondet e përdorura dhe rezultatet e arritura, të cilat i prezantohen Këshillit Bashkiak dhe palëve të interesuara.	Vjetore	Bashkia Malësi e Madhe; Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Ndihmës Ekonomike
Konsultimi publik	Prezantimi i progresit dhe diskutimi me qytetarët, grupet e interesit dhe OJF-të, për të rritur transparencën dhe besimin.	Sipas nevojës	Drejtoria Juridike; Partnerë OJF

Mekanizmat e mësipërm të monitorimit dhe raportimit krijojnë një **proces gjithëpërfshirës dhe transparent**, ku çdo institucion ka rol të qartë dhe të lidhur ngushtë me përgjegjësitë e veta. Të dhënat e mbledhura nuk përdoren vetëm për raportim formal, por edhe për **analizë dhe rishikim të vazhdueshëm të programeve**, duke i dhënë mundësi Bashkisë të përshtasë ndërhyrjet sipas nevojave reale dhe emergjente të komunitetit.

Raportimi vjetor garanton llogaridhënie para Këshillit Bashkiak dhe partnerëve, ndërsa konsultimet publike rrisin transparencën dhe besimin e qytetarëve. Kështu, Bashkia Malësi e Madhe siguron që politikat e strehimit social të mbeten dinamike, të harmonizuara me realitetin lokal dhe të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë së jetesë.

Analiza e Riskut



Ky seksion ka për qëllim të evidentojë risqet kryesore që mund të ndikojnë në zbatimin efektiv të programeve prioritare të strehimit social 2026–2030, duke përfshirë Banesa Sociale / me kosto të ulët, Përmirësimi i Banesave Ekzistuese, Banesa të Përkohshme, Banesa të Specializuara, Zhvillimi i Zonave për Strehim Social, Bonus Strehimi dhe Kredia e Butë.

*Analiza e Riskut për Programet e Strehimit Social*

Nënobjektivi	Rreziku	Masa Zbutëse	Institucioni Përgjegjës	Periodha	Niveli i Riskut
Hartëzimi i grupeve vulnerabël	Mungesë stafi për vëzhgime; mungesë fondesh për databazë	Punësim/transferim stafi; financim nga buxheti vendor & donatorët	Bashkia Malësi e Madhe; Drejtoria e Ndhmës Ekonomike & Sociale	2026–2027	Mesatar
Sistemi i informacionit për aplikime	Mungesë ekspertize teknike; kapacitete të pamjaftueshme	Partneritet teknik me AKSHI/OJF; trajnime stafi; integrim me platformat kombëtare	Drejtoria Juridike; OJF	2026–2028	Mesatar
Përmirësimi i banesave ekzistuese	Vonesa në tendera & kontrata; probleme me kontraktorët	Planifikim i kujdesshëm; monitorim teknik i rreptë; auditim i pavarur	Drejtoria Juridike; Drejtoria e Planifikimit & Infrastrukturës	2026–2030	Lartë
Zhvillimi i zonave sociale	Kosto të paparashikuara; mospërputhje me planet urbane; mungesë trualli	Rezervë buxhetore; konsultim me urbanistë; përdorim i tokës publike	Bashkia Malësi e Madhe; Drejtoria e Planifikimit; Qeveria Qendrore	2027–2030	Lartë
Banesa të përkohshme	Rritje e kërkesave emergjente mbi kapacitetet ekzistuese	Fond emergjent; marrëveshje me donatorë për struktura të përkohshme	Bashkia Malësi e Madhe; Qeveria Qendrore; OJF	2026–2028	Mesatar

Analiza e riskut është një element kritik për miratimin në nivel qendror, pasi ndihmon në parashikimin dhe menaxhimin e situatave të paparashikuara që mund të vonojnë ose pengojnë realizimin e projekteve..



**Përmbledhja Operacionale e Planit të Strehimit Social 2026–2030**

Plani Vendor i Strehimit Social për Bashkinë Malësi e Madhe për periudhën 2026–2030 përfaqëson një angazhim institucional për të garantuar kushte më të mira jetese për qytetarët në nevojë. Ai është

hartuar në përputhje me Ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social” dhe udhëzuesit përkatës, duke u bazuar në analizën e grupeve vulnerabël, gjendjen e tregut të banesave dhe të dhënat statistikore më të fundit

**Plani bazohet në dy shtylla kryesore:**

1. Përdorimi dhe përmirësimi i fondit ekzistues të banesave përmes rikonstruksionit, përshtatjes dhe ripërdorimit të stokut të zbrazët.
2. Krijimi i alternativave të reja të strehimit social përmes ndërtimit të banesave kolektive dhe zhvillimit të zonave të dedikuara për strehim.

Programi / Masa	Përshkrimi i Veprimeve	Objektivi Kryesor	Grupi Përfitues	Indikatori i Monitorimit	Afati	Buxheti	Institucioni Përgjegjës	Partnerët Mbështetës
Qira Sociale	Subvencionim qiraje për familjet me të ardhura të ulëta	Sigurimi i aksesit në strehim të përballueshëm	Familje vulnerabël, PAK	Nr. familjeve përfituese/vit	2026–2030	Buxheti i Bashkisë	Bashkia Malësi e Madhe	Shteti, Donatorë
Rritja e Fondit të Banesave Sociale	Rikonstruksion i banesave të papërdorura për strehim social	Zgjerimi i stokut të banesave sociale	Familje vulnerabël	Nr. banesave të rikonstruara	2026–2030	Buxheti i Shtetit	Bashkia Malësi e Madhe	Donatorë, OJF
Trualli Publik për Strehim	Vendosje e truallit në dispozicion për banesa sociale	Sigurimi i hapësirave për ndërtim	Të gjithë qytetarët në nevojë	Hektar tokë e planifikuar	2026–2030	Pa kosto direkte	Bashkia Malësi e Madhe	AKPT, Partnerë
Rehabilitimi i Banesave Ekzistuese	Ndërrhyrje në banesa urbane/rurale të amortizuara	Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese	Familje vulnerabël	Nr. ndërrhyrjeve/vit	2026–2030	Beti i Shtetit + Donatorë	Bashkia Malësi e Madhe	OJF, Partnerë
Banesa të Specializuara	Banesa për PAK, të moshuar, viktimat dhune	Integrimi social dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël	PAK, të moshuar, viktimat dhune	Nr. banesave të specializuara	2027–2030	Buxheti i Shtetit + Donatorë	Bashkia Malësi e Madhe	OJF
Banesa të Përkohshme	Strehim emergjent në raste fatkeqësish	Sigurimi i strehimit të menjëhershëm	Refugjatë, individë të zhvendosur	Nr. rasteve të mbuluara/vit	2026–2030	Buxheti i Shtetit	Bashkia Malësi e Madhe	Emergjencja Civile
Bonus Strehimi	Subvencionim qiraje për familjet e zhvendosura	Kompensim për zhvendosje nga projektet publike	Familje të zhvendosura	Nr. familjeve të mbështetura/vit	2026–2028	Fondi i Bonuseve	Bashkia Malësi e Madhe, Enti i Banesave	Donatorë
Kredia e Butë	Subvencionim i interesave për kredi hipotekore	Lehtësimi i aksesit në pronësi banese	Të rinj, çiftet e reja, familje me të ardhura të ulëta	Nr. kredive të miratuara/vit	2026–2030	Qeveria + Bankat + Bashkia	Bashkia Malësi e Madhe	Donatorë, Bankat
Zhvillimi i Zonave Sociale	Planifikim dhe ndërtim lagjesh sociale	Urbanizim i qëndrueshëm dhe krijim stok të ri	Familje në nevojë, komunitete vulnerabël	Nr. banesave lagjeve të ndërtuara	2026–2030	Buxheti i Shtetit, PPP, Donatorë	Bashkia Malësi e Madhe	Sektor Privat, Partnerë



Zbatimi i programeve përfshin ndërhyrje afatshkurtra, si subvencionimi i qirave, strehimi i përkohshëm dhe përdorimi i banesave të jashtëzakonshme, si dhe masa afatgjata për ndërtimin e banesave të reja sociale, zhvillimin e zonave të dedikuara dhe forcimin e infrastrukturës urbane. Fokusi vendoset tek grupet vulnerabël dhe familjet me të ardhura të kufizuara, të cilat përballen me vështirësi për të hyrë në tregun e lirë të banesave.

#### *Programet dhe Masat Operacionale të Programeve të Strehimit Social*

Ky Plan 5-vjeçar krijon një sistem strehimi funksional, të aksesueshëm dhe të qëndrueshëm, duke integruar programet afatshkurtra dhe afatgjata për të mbështetur grupet vulnerabël. Bashkia Malësi e Madhe synon:

- Forcimin e kapaciteteve institucionale;
- Zgjerimin e partneriteteve me qeverinë qendrore dhe donatorët;
- Menaxhim transparent dhe gjithëpërfshirës të burimeve;
- Integrim urban dhe social për një zhvillim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm.

Ky dokument shërben si udhëzues operacional për zbatim, monitorim dhe raportim, duke e kthyer planin strategjik në veprime konkrete për periudhën 2026–2030.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 744 Prot

Koplik më: 13 / 103 / 2026

Njoftim

Dëgjesë publike me temë:

"Mbi Planin e Strehimit Bashkia Malësi e Madhe"

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik".

Ju njoftojmë se:

Ditën e Ejte më datë 26.03.2026 ora 10:00, në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, familje të pastreha, shoqëri civile, qytetarë të Bashkisë Malësi e Madhe, përfaqësues të Bashkisë Malësi e Madhe dhe grupe të tjera interesi, lidhur mbi dëgjesën publike me temë: "Mbi Planin e Strehimit Bashkia Malësi e Madhe"

Ky konsultim publik synon të njoh grupet e interesit me "Mbi Planin e Strehimit Bashkia Malësi e Madhe", dhe të mbledh sugjerimet dhe rekomandimet lidhur me këtë dokument me qëllim përmirësimin e tij. Plani synon të ulë numrin e familjeve të pastreha dhe tu vij në ndihmë grupeve vulnerabël, personave me aftësi ndryshe etj.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjesë publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.



Sekretari i Këshillit

Emirjan Hasmujaj

Adresa: Koplik-Qender

tel: 021122650/2651

e-mail: bashkiamalesimadhe@hotmail.com





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA MALËSI E MADHE**  
**SEKTORI I SHERBIMEVE SOCIALE**

Nr. 754 Prot.

Koplik, më 13.03.2026

**NJOFTIM**

Bazuar ne ligjin Nr.146/2014 “Për Njoftim për konsultim publik” dhe ligjit Nr.139/2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”i ndryshuar. Ligjit nr.22/2018,“Per Strehimin Social ne Republiken e Shqiperise, Ligji Nr.121/2016 Per Sherbimet e kujdesit Shoqror ne Republiken e Shqiperise në orën 10.00 datë 26.03.2026 në Këshillin Bashkiak Malësi e Madhe do të zhvillohet dëgjesa Publike për hartimin e Planit të Strehimit Social 2026-2030.

**KRYETAR**

**TONIN MARINAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE

Nr. 754 / Prot.

Koplik, me: 26.03.2026

**Raporti përmbledhës i dëgjësës publike në lidhje me Planin e Strehimit Social 2026-2030**

I mbajtur sot me datë 26.03.2026 për konsultimin publik për prezantimin e Planit të Strehimit në Bashkinë Malësi e Madhe, në mbështetje të Ligjit nr 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Në këtë mbledhje u diskutua për Planin e Strehimit Social 2026-2030, një dokument strategjik i përgatitur nga Grupi i punës i ngritur me urdhër nr 29 të kryetarit të bashkisë nr. prot. 349 datë 06/02/2026 i bazuar në të dhënat e mbledhura nga të gjitha aktorët kryesorë si Sektori i Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit të Aseteve. Në takim u diskutua në lidhje me hartimin e programit 5-vjeçar të strehimit social për Bashkinë Malësi e Madhe 2026–2030 ku do të identifikohen grupet vulnerabël dhe nevojat e tyre për strehim, si dhe të propozojë alternativa afatmesme për sigurimin e strehimit të përballueshëm, në përputhje me programet dhe dispozitat e legjislacionit përkatës. Në bazë të nenit 68 të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare të strehimit social për popullsinë nën juridiksionin e tyre, të cilat miratohen nga Këshilli Bashkiak i Malësi e Madhe. Në takim u diskutua për nevojat për strehim social për grupet e përcaktuara nga ligji, me fokus të veçantë tek familjet dhe individët në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe, ku do të analizohen kapacitetet njerëzore, teknike, financiare dhe organizative të bashkisë për të adresuar nevojat e identifikuara. Të propozojë ndërhyrje konkrete, të shoqëruara me vlerësime të qarta buxhetore dhe instrumente ligjore e financiare që mundësojnë zbatimin e tyre. Të forcojë kohezionin social dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm përmes politikave të strehimit të përballueshëm.

Specialiste Strehimi

Liridona Balaj

Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Sociale

Ilda Rexhaj

Sekretar Këshilli

Emirjan Hasmujaj





Aktiviteti: Dëgjësë Publike. Plan i Shtrehimit 2026-2030

Vendodhja: Bashkia Malësi e Madhe

Data: 26.03.2026



## LISTA E PJESMARRËSVE

Nr	Emër/Mbiemër	Institucioni	Kontakt/ E-mail/ Mob	Firma
1	Emriqim Hasmajaj	SEKRETARË KESHILLIT	emriqim.h@keshillit.com	
2	Enxhela Samokaj	Specjaliste NE/PAK-SES	enxhela.samokaj@outlook.com	
3	Enxhela Enxheli	POZICIA BASHKIMIARE	enxhela.enxheli@gmail.com	
4	Albentor Haxho	Policia Bashkia	albentor.haxho@mb.com	
5	ETER. QAFENI	PERCIT, Priva, Rr. R		
6	Emira Heta	Perq. Sht. Ashtur' B/M	emiraheta@gmail.com	
7	Kristjana Gjokaj	Shkollge Bashkia, H. Halbe	kristjanagjokaj@gmail.com	
8	Dhensela Karaj	Funonjese sociale B.M	dhenselakaraj@gmail.com	
9	Anxhela Karkaj	Shkollge, Nr. Adm. Kostaj	anxhela.karkaj@gmail.com	
10	Sobira Dary	Shkollge, Nr. Adm. Shkel	sobiradary@gmail.com	
11	Elizabeta Carvaj	Inferjere Perq. Rr. R	elizabethacarvaj@gmail.com	





12	Franc Vukobratović	P. M. Marković	www.konac@pshn.org.rs	
13	ERMIJA KRAJČIĆ	I. V. M. T.	0676988898	
14	Radica J. J. J.	M. J. V. J. J.	0692764695	
15	Radica Vukobratović	D. A. J. J.	06922592212	
16	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0692629762	
17	M. J. J. J.	M. J. J. J.	06886406504	
18	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0677274551	
19	M. J. J. J.	M. J. J. J.	06922845325	
20	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0696680318	
21	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0676488263	
22	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0683142248	
23	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0683922682	
24	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0688206527	
25	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0685163815	
26	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0693543705	
27	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0692190823	
28	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0693828852	
29	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0674518048	
30	M. J. J. J.	M. J. J. J.	0696885315	





Aktiviteti: Dëgjese Publike. Plani i Strehimit 2026-2030

Vendodhja: Bashkia Malësi e Madhe

Data: 26.03.2026

## LISTA E PJESMARRËSVE



Nr	Emër/Mbierëm	Institucioni	Kontakt/ /E-mail/ Mob	Firma
1	Arnallan Kurtaj	Dajtkaj	0695120264	[Signature]
2	Johno Sylka	Bashkia M. Madhe	0686885335	[Signature]
3	Elvana Shkripaj	Bashkia M. Madhe	0697332855	[Signature]
4	Arindana Dolej	Bashkia M. Madhe	0675001010	[Signature]
5	Stjepanë Lulej	Bashkia M. Madhe	0686958482	[Signature]
6	Stela Rastaj	Bashkia M. Madhe	0674355383	[Signature]
7	Talim Nolej	B.M.M	0673513338	[Signature]
8	Stjepan Dolej	M. H.M. Bashkia	0686451246	[Signature]
9	Vera Rudaj	M. H.M. Bashkia	0673054127	[Signature]
10	Milan Smeraj	Mes. P. T. -	0683624810	[Signature]
11	Senad Dajtkaj	Keshilltore	0673814860	[Signature]



12	Tejandra	Supelliy	Kasturba	0676663033	
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					

